

## **Ndajshtimi i paveçuar-disa çështje në rrafshin sintaksor dhe semantik<sup>1</sup>**

### **Abstrakt**

Tradicionalisht kontributi i gjuhëtarëve gjermano-folës në gjuhësinë shqiptare ka një rol të rëndësishëm dhe të veçantë, qoftë në studimet diakronike e po ashtu edhe në studimet sinkronike. Këto kontribute përveç tjerave janë përplot analiza kontrastive ndërmjet gjuhës shqipe dhe gjermane. Padyshim se ato paraqesin një bazë solide për analiza të mëtutjeshme, të cilat mund të thellohen por, kur paraqitet nevoja, eventualisht edhe të korrigojnë. Kështu p. sh. Gerda Ullrich, gjatë një analize të saj kontrastivo-tipologjike, pohon se ndajshtimi në gjuhën shqipe përputhet tërësisht për nga forma dhe përmbajtja me ndajshtimin në gjuhën gjermane. Duke përdorur kriterin e ko-identitetit gramatikor dhe semantik ndërmjet gjymtyrës bosht dhe ndajshtimit, në këtë punim do të dëshmojmë se ndajshtimi i paveçuar në gjuhën shqipe ka përputhje vetëm të një numri të kufizuar të konstruksioneve ndajshtimore. Shumica e konstruksioneve ka s'përputhje sidomos në rrafshin sintaksor, duke shfaqur tendencë të bashkërenditjes në gjuhën gjermane dhe tendencë të nënrenditjes strukturore në gjuhën shqipe ndërmjet gjymtyrës bosht dhe ndajshtimit. Gjithashtu, në punim dëshmojmë edhe raste të konstruksioneve të cilat ka s'përputhje ndërmjet dy gjuhëve në të gjitha rrafshet gjuhësore, duke përfshirë pra edhe rrafshin fonetik.

### **1. Hyrje**

Kontributi i gjuhëtarëve gjermano-folës në gjuhësinë shqiptare ka qenë dhe është i konsiderueshëm. Ai luan një rol të rëndësishëm dhe zë një vend të veçantë, qoftë në studimet diakronike e po ashtu edhe në studimet sinkronike të gjuhës shqipe. Përveç kësaj, këto kontribute janë njëkohësisht me përplot analiza kontrastive ndërmjet gjuhës shqipe dhe gjermane. Padyshim se ato paraqesin një bazë solide dhe një burim shumë të vlefshëm, sidomos për studentët shqipfolës të gjuhës gjermane. Në disa raste këto analiza mund të rishikohen dhe thellohen por, nëse paraqitet nevoja, ato mund të modifikohen, por edhe të avancohen. Një rishikim gjegjësisht modifikim të tillë do ta bëjmë me pohimin e Gerda Ullrich, e cila gjatë një analize kontrastivo-tipologjike<sup>2</sup> pohon se ndajshtimi në gjuhën shqipe përputhet tërësisht për nga forma dhe përmbajtja me ndajshtimin në gjuhën gjermane.

Para se të fillojmë me analizë, duhet të themi se ky konstatim i Ullrich është për së paku tri arsye paksa i papritur: (i) ajo në faqen 113 të disertacionit të saj pohon se do të shmanget ballafaqimit me ndajshtimin dhe e përmend atë dhe ndërtimin e tij përciptazi, vetëm si një rast të veçantë të përcaktorit, (ii) problematika e ndajshtimit apo apozicionit, siç do të dëshmojmë më

---

<sup>1</sup> Disa pjesë të kësaj analize janë prekur pjesërisht edhe në konferencat ndërkombëtare të DIMOS (Deutsch In Mittel-,Ost-und Südosteuropa), vitin e kaluar (2016) në Regensburg dhe sivjet (2017) në Prishtinë. Punimi në Regensburg është në botimi e sipër (Abrashi (në botim)), kurse ai i Prishtinës është në proces të botimit (Abrashi (në proces të botimit)).

<sup>2</sup> Ullrich (1982)

poshtë, është tejet e komplikuar dhe ngatërruese, dhe (iii) lehtësia e një konstatimi të tillë, përkundër faktit se në gjuhësinë gjermane, por edhe të tjerat (p. sh. angleze), nuk ka ndonjë pajtueshmëri të plotë se ç'kuptojmë me konceptin apozicion dhe si është i ndërtuar gjegjësisht ç'strukturë sintaksore ka ai. Lidhur me arsyen (ii) mund të themi, se kjo problematikë në literaturë është bukur e rrahur, por pavarësisht këtij fakti, shumë çështje të kësaj problematike kanë mbetur ende të hapura. Këtu po sjellim konstatimin e gjuhëtarit me prejardhje hungareze nga Gjermania, Vilmos Agel, i cili në librin e tij rreth analizës gramatikore të tekstit, të botuar rishtazi (2017), konstaton se në gramatikën gjermane, vështirë se ekziston një dukuri me problematike dhe më e ngatërruar sesa e ndajshtimit (Agel 2017:773)<sup>3</sup>. Për këtë konstatim ai nuk është i vetmuar. Ngjashëm mendon edhe Peter Eisenberg, i cili në ribotimin e gramatikës së tij (Eisenberg 2013), ripohon se në gramatikën e gjuhës gjermane ende nuk ka një konsensus se çka nënkuptohet me ndajshtim (Eisenberg 2013: 256)<sup>4</sup>. Po i njëjti konstatim del edhe nga studimi i Schindler (1990), por edhe te studimet e mëhershme siç është p. sh. Molitor (1979) etj. Ngjashëm është edhe në gjuhën angleze. Kështu p. sh. Acuna-Farina, një ndër studiuesit më të cituar rreth problematikës së ndajshtimit në gjuhën angleze, konstaton në një punim të botuar së voni (2006), se në gjuhën angleze ende nuk ka pajtueshmëri për çështje themelore si p. sh. ndërtimi dhe struktura e të ashtuquajturit ndajshtim të paveçuar<sup>5</sup>. Një fakt të tillë e dëshmon edhe monografia e Meyer (1992) e gjithashtu edhe punimi i mëhershëm i Burton-Roberts (1975) etj.

Duke marr parasysh kompleksitetin e kësaj problematike si dhe duke mos pretenduar për të shterur të gjitha çështjet e hapura të përfolura nga gjuhëtarët e sipërpërmendur, analiza jonë do të tregojë se ndërmjet ndajshtimit të gjuhës shqipe dhe atij të gjuhës gjermane, ekzistojnë dallime si në rrafshin sintaksor e po ashtu edhe në rrafshin e tjera të gjuhës (fonetik, morfologjik dhe semantik).

## 2. Disa njohuri të përgjithshme rreth ndajshtimit

Tradicionalisht ndajshtimi konsiderohet një konstruksion gjuhësor ndërmjet dy përbërësve apo gjymtyrëve emërore. Njëri konsiderohet gjymtyrë bosht, kurse tjetri është ndajshtimi. Lidhja ndërmjet këtyre gjymtyrëve mund të jetë e veçuar dhe e paveçuar. Në gjuhën e folur veçimi i lidhjes bëhet me pauze (apo heshtje të shkurtë) para se folësi të thotë ndajshtimin, kurse në gjuhën e shkruar ky veçim bëhet zakonisht me presje. Lidhja e paveçuar ndërmjet këtyre dy gjymtyrëve emërore në gjuhën e folur konstituon në një njësi intonacioni të vetme dhe gjymtyrët nuk veçohen me ndonjë heshtje apo pauzë. Në gramatikat e gjuhës shqipe, ndajshtimi te konstruktet me lidhje të ndashme quhet ndajshtimi i veçuar, kurse ai me lidhje të pandashme quhet ndajshtim i paveçuar. Në këtë punim do të përqendrohemi vetëm te ndajshtimi i paveçuar, i cili sipas gramatikës së Akademisë është lloji më i përhapur i ndajshtimit<sup>6</sup>.

Si në gramatikat e gjuhës shqipe e po ashtu edhe në gramatikat e gjuhës gjermane dhe angleze, ndajshtimi konsiderohet si një rast i veçantë i përcaktorit gjegjësisht atributit. Kështu supozon edhe Uhlisch (1979: 113). Konstruksioni me ndajshtim të paveçuar zakonisht shfaqet si një lidhje me bashkim ndërmjet dy emrave: emri bosht dhe ndajshtimi. Mirëpo në vend të emrit

<sup>3</sup> "In der deutschen Grammatik gibt es kaum einen verwirrenderen Phänomen- und ungelösteren Problembereich als den der sog. Appositionen" (fq. 773)

<sup>4</sup> Es besteht keine Einigkeit darüber, was unter ›Apposition‹ zu verstehen ist. (fq. 256)

<sup>5</sup> The concept of apposition remains an obscure notion despite the fact that it has figured prominently in the history of grammar. Modern grammatical frameworks have done very little if anything to clarify it ... (fq. 1)

<sup>6</sup> fq. 237

bosht mund të shfaqet edhe përemri. Ndajshtimi hyn në relacion me gjymtyrët e tjera të fjalisë vetëm nëpërmjet gjymtyrës bosht dhe në këtë mënyrë është (tërthorazi) pjesë e të gjitha funksioneve gramatikore, të cilat mund ti bartë një sintagmë nominale në kuadër të fjalisë. Përtej fjalisë, funksioni i tij është pikësëpari informativ<sup>7</sup>. Ai jep informata shitesë për një entitet në diskurs, duke ngërthyer kështu nuanca informative përshkruese apo nuanca informatave identifikuese për emrin bosht. Përdorimi i një mjeti të tillë gjuhësor (për dallim nga përcaktori) nuk shërben për të kufizuar sendin (subjektin) e të folurit, por ai përdoret për të dhënë më shumë informacion për sendin tashmë të përcaktuar në diskurs<sup>8</sup>. Thënë ndryshe, ky mjet gjuhësor nuk kontribuon drejtpërdrejt në funksionalitetin e sintagmës emërore të ngërthyer brenda saj. Por, kjo nuk do të thotë se fjala është për një informacion dytësor apo një informatë më pak relevante ose në pikëpamje komunikative të panevojshme. Jo rrallë, këto mjete bartin informata të rëndësishme, madje ironike e qëllimkëqija (apo qëllimmira), të cilat në këtë pozicion nuk pohohen në mënyrë eksplicite, por ato thjesht përfshihen gjatë të folurit<sup>9</sup>.

Sidoqoftë, si rrjedhim i përmbushjes së funksionit të një informacioni shitesë, ashtu siç u specifikua më lart, të dy përbërësit e konstruksionit me ndajshtim ishte dashur ti referohen po të njëjtit entitetit. Këtë fakt e theksojnë shumica e gramatikave të gjuhës shqipe dhe të gjuhës gjermane. Për gjuhën shqipe po e parafrazoj Domin (1971:22) i cili në sintaksën e tij pohon se ndajshtimi bënë të shënuarit e të njëjtit njeri a send me fjalë të ndryshme nga emri bosht apo përemri. Ngjashëm pohon edhe Gramatika e Akademisë 2 (2002: 216) dhe e Becit (2005:223). Po kështu është edhe te gramatikat e gjuhës gjermane. Këtu po përmendim gramatikën e Eisenbergut (2013:259) dhe Helbig /Buscha (1996:606) të cilat e potencojnë një dukuri të tillë. Disa gramatika të tjera, si p. sh ajo e Institutit të Gjuhës Gjermane në Mannheim gjegjësisht Zifonun (1997: 2014), mendon se ko-referenca ndërmjet emrit bosht dhe ndajshimit mund të realizohet vetëm nëpërmjet relacionit kallëzuesor. Te kjo gramatikë lidhja kallëzuesore është identike me lidhjen këpujore ndërmjet kryefjalës përkatësisht përemrit anaforik të kryefjalës dhe plotësit emëror të këpujës. Kështu p. sh. te konstruksioni ndajshtimor:

(1) Komisari Memo.

<sup>7</sup> Një analizë e funksionit të ndajshimit të paveçuar përtej fjalisë, për dallim nga gjuha gjermane dhe angleze, mjerisht në gjuhën shqipe ende nuk është bërë. Sikur të ishte bërë, atëherë, përveç tjerave, po supozoj se do të ishte më e qartë se pse një lloj apo konstruksion i caktuar i ndajshimit të paveçuar në një zhanër dhe kontest të caktuar është më i preferuar se një tjetër. Për fat të keq në gjuhën shqipe nuk ka gjithashtu një analizë se te cilat zhanre tekstore apo në cilin diskurs përdoret më shumë apo më pak ndajshtimi. Por, nëse merren parasysh rezultatet e analizave për gjuhën gjermane dhe angleze, atëherë mund të supozohet se ndajshtimi është shumë më shumë i pranishëm p. sh. te reportazhet gazetareske sesa gjatë bashkëbisedimit ndërmjet dy bashkëbiseduesve përball njëri tjetrit (shiko p. sh. Acuna-Farina 1994: 322). Shpjegimi logjik i një përdorimi më të madh në rastin e reportazheve gazetareske është se njohuritë e përbashkëta ndërmjet folësit dhe participantëve të diskursit, ose më mirë të themi folësi ka bindjen, se në këtë konstalacion diskursiv njohuritë e përbashkëta janë shumë më të vogla sesa ndërmjet dy participantëve të cilët që më parë e njohin njëri tjetrin. Rrjedhimisht, kur dy bashkëbisedues komunikojnë, shumë shpesh nuk ka nevojë për informata identifikuese ose informata shitesë për koncepte sapo të futura në bisedë. Lidhur me funksionin dhe llojin e ndajshimit të paveçuar përtej fjalisë, shiko më gjerësisht Abrashi (në proces të botimit).

<sup>8</sup> Si dëshmi se sendi është tashmë i pranishëm në diskurs mund të shërben edhe prania e njëjës shquese te gjymtyra (emri) bosht, e cila mungon te sendet e sapo të futura në diskurs. Në këto raste (zakonisht) është e pranishme nyja jo shquese (një).

<sup>9</sup> Shiko shembullin e marr nga Prifti (1971: 101): *Afiz Pasha kryelopa*. Rreth një komenti eventual didaktik të ndajshimit shiko Hoffmann (2013: 202)

ku *komisari* është emri bosht ndërkaq *Memo* është ndajshtimi, lidhja kallëzuesore për të cilën pretendon gramatika e institutit, është:

(2) Komisari është Memo.

apo, nëpërmjet përemrit anaforik të kryefjalës:

(3) Komisari-ai është Memo.

Arsyeja se përse disa gramatika nuk e pranojnë ko-referencën e drejtpërdrejtë është se ato pretendojnë se lidhja ndërmjet emrit bosht dhe ndajshtimit e kufizon më ndryshe ekstensionin apo, siç e quan Prifti (1971:96), shtrirjen e konceptit të emrit bosht, se sa përcaktori, që në esencë përputhet me komentin didaktik rreth ndajshtimit (si informacion shtesë) që u tha më lart. Thënë ndryshe, lidhja kallëzuesore apo predikative preferohet për të treguar se ndërmjet gjymtyrës bosht dhe ndajshtimit nuk ka lidhje atributive sikurse te përcaktori, por vetëm predikative. Mirëpo, për shkak të strukturës së qartë asimetrike ndërmjet të dy gjymtyrëve në gjuhën shqipe, lidhja predikative nuk jep ndonjë zgjidhje siç jep në gjuhën gjermane.

### 3. Analiza në rrafshin sintaksor e morfologjik

Një veti karakteristike e ndajshtimit të paveçuar është se ai nuk lakohet dhe mbetet gjithnjë i pashquar në rasën emërore, pavarësisht se në ç'rasë është emri bosht:

- |   |                                       |       |
|---|---------------------------------------|-------|
| (4) a. Ky është <i>komisar</i> Memoja.        | Dies ist <i>Kommissar</i> Memo.       | (NOM) |
| b. Një propozim i <i>komisar</i> Memos        | Ein Vorschlag <i>Kommissar</i> Memos. | (GEN) |
| c. Ne i besojmë <i>komisar</i> Memos          | Wir vertrauen <i>Kommissar</i> Memo.  | (DAT) |
| d. Ne e përjashtuam <i>komisar</i> Memon      | Wir verjagen <i>Kommissar</i> Memo.   | (AKK) |
| e. Këtë se prisnim prej <i>komisar</i> Memos. |                                       | (ABL) |

Siç vërejmë në shembullin (4), kështu ndodh në të dyja gjuhët<sup>10</sup>: ndajshtimi gjegjësisht emri i përgjithshëm *komisar* në gjuhën shqipe dhe *Kommissar* në gjuhën gjermane nuk e ndërron formën në asnjë rasë. Por, kështu nuk ndodh edhe me emrin bosht gjegjësisht me emrin e përveçëm *Memo*. Ai ndërron formën e tij në të dy gjuhët, rrjedhimisht lakohet. Por për shkak të sinkretizmave ky lakim nuk është i dallueshëm në secilën rasë. Në gjuhën shqipe na shfaqen tri forma (*Memoja*, *Memos* dhe *Memon*), kurse në gjuhën gjermane vetëm dy (*Memo* dhe *Memos*), të cilat dallohen nëpërmjet mbaresave rasore. Në gjuhën shqipe këto mbaresa rasore janë në fakt format rasore të nyjës së prapavendosur, prania e së cilës është e domosdoshme edhe te emrat e përveçëm. Kurse, në gjuhën gjermane mbaresa e vetme rasore e shfaqur, është mbaresa rasore e emrit në gjinore (-s), e cila në fakt na lë të kuptojmë se emri lakohet, përndryshe për shkak të rrafshimit të mbaresave në rasat e tjera lakimi nuk është i dukshëm. Por, nëse në këtë gjuhë emri nuk është i përcjell nga nyja shquese proklitike, atëherë kjo mbaresë rasore është karakteristike vetëm për emrat e përveçëm, sepse në këtë gjuhë këta emra nuk shfaqen me nyja. Prandaj, duke

<sup>10</sup> Shiko Beci (2005: 223) për gjuhën shqipe dhe Eisenberg (2013: 259) dhe DUDEN (2016: 994) për gjuhën gjermane (Titel und Eigennamen: Zusammenfassung)

marr parasysh shembullin (4) dhe atë që u tha më sipër, konstruksioni me ndajshtim në emërore ka këtë strukturë sintaksore:

- (5) a.  $[[NP_{NOM}] + [NP_{NOM} + DET_{NOM}]]$  (për gjuhën shqipe) dhe  
 b.  $[NP_{NOM}] + [NP_{NOM}]$  (për gjuhën gjermane)

me ç'rast NP paraqet sintagmën emërore të përbërë nga një emër të pa përcaktuar, si një send me kuptimin e vet më të përgjithshëm, i cili barazohet me tiparin e një predikati. Kurse DET paraqet një, roli i së cilës është të konkretizon këtë kuptim të përgjithësuar të emrit duke e shndërruar atë nga një tipar në një send apo në një entitet konkret. Rrjedhimisht, duke bashkuar  $[NP + DET] = [DP]$  fitohet një sintagmë e re, e cila quhet sintagmë determinante<sup>11</sup> dhe paraqet sintagmën e një emri të konkretizuar në një diskurs të caktuar. Kurse në rrafshin sintaksor, ndajshtimi del në emëroren e pashquar në të dy gjuhët, që në fakt për nga forma është një emër identik si një emër pa mbaresë rasore  $[\emptyset]$ , prandaj në vend të  $[NP_{NOM}]$  atë po e shënojmë me  $[NP_{\emptyset}]$ <sup>12</sup>. Si rrjedhojë, struktura sintaksore në (5) merr formën:

- (6) a.  $[NP_{\emptyset}] + [DP_{NOM}]$  (për gjuhën shqipe), dhe  
 b.  $[NP_{\emptyset}] + [NP_{NOM}]$  (për gjuhën gjermane)

dhe në shikim të parë, krahasimi i strukturave ndërmjet dy gjuhëve shfaq një dallim ndërmjet strukturave sintaksore të konstruksioneve ndajshtimore të shqipes dhe gjermanishtes. Mirëpo, nëse kihet parasysh se pozicioni D (koka e sintagmës determinante<sup>13</sup>) sipas Longobardit (1994) është pozicioni ku vendoset nyja si dhe lokusi ku realizohet funksioni i argumentit të një sintagme emërore, atëherë vetëm lidhja e sintagmës emërore (NP) me këtë pozicion e kualifikon atë për të kryer funksionin e kryefjalës brenda fjalisë, qoftë nëpërmjet tiparit  $[+R]$ <sup>14</sup> ose zhvendosjes së vet sintagmës emërore në këtë pozicion. Thënë ndryshe, pozicioni D e shndërron sintagmën emërore (NP) në sintagmë determinante (DP), e cila vetëm si e tillë (pra si DP) mund të zë pozicionin e kryefjalës së fjalisë. Në gjuhën shqipe një shndërrim i tillë realizohet vetëm nëpërmjet lidhjes, sepse në shqipe asnjë sintagmë nominale nuk mund të kualifikohet për të kryer funksionin e kryefjalës pa qenë e pranishme nyja<sup>15</sup> apo ndonjë tjetër përcaktor ekuivalent<sup>16</sup>,

<sup>11</sup> Lidhur me sintagmën determinante shiko Koleci/ Turano (2011: 65-67)

<sup>12</sup> Buhholz/Fiedler (1987:423) rasën e ndajshtimit e quan *merkmallose Kasus*, që shqip mund të përkthehet (fjalë për fjalë) si rasë pa tipare., Prandaj këtë veti po e shënojmë këtu me  $[\emptyset]$ , që si simbol shënon diçka të zbrazët. Lidhur me këtë çështje shiko edhe Bhatt (1990: 65), e cila emëroren e pashquar e quan formë rasore e pamarkuar e gjuhës gjermane (die unmarkierte Kasusform des Deutschen)

<sup>13</sup> Rreth kokës së sintagmës emërore në gjuhën shqipe dhe gjuhën gjermane shiko Abrashi (2009)

<sup>14</sup> Referencës

<sup>15</sup> Lidhur me këtë çështje në këtë punim do të ndjekim Buchholz/Fiedler (1987: 235) sipas të cilëve: "Wenn das Subst Subjekt des Satzes ist, kommt im Alb. der  $\emptyset$ -Artikel nicht in Frage (Kur emri është kryefjalë e fjalisë, nyja- $\emptyset$  (nyja zero TA.) në gjuhën shqipe nuk vjen fare në konsiderim. Përkthimi T. A.).

<sup>16</sup> Pohimi i Çelikut (2012: 139) se në gjuhën shqipe funksionin e kryefjalës mund ta kryejnë edhe emrat të pa shoqëruar me nyja apo me një caktuesor (siç i quan ai) qoftë në njëjës apo në shumës si p. sh. *Makinë ndaloi para universitetit /Makina ndaluan pranë universitetit*, është i papritur dhe kujtoj se kërkon sqarime dhe elaborim shtesë nga autori, qofshin këta dy shembuj edhe një përgjigje, siç thotë ai në fq. 95, në pyetjen: *A ndaloi/ndaluan makinë/ makina apo autobus pranë universitetit?* Sepse konsideroi, se pa përfshirjen eventualisht të emrit të dytë (*autobus*) në përgjigjen e pyetjes së lartpërmendur: *Makinë (e jo autobus) ndaloi pranë universitetit apo Pranë universitetit ndaloi makinë (e jo autobus)* vështirë se është në përputhje me strukturën informative të fjalisë së gjuhës shqipe, por edhe të gjuhëve të tjera. Kështu p. sh. në gjermanishte vetëm në rast kur renditen së paku dy emra të përgjithshëm

madje kështu duhet të jetë edhe atëherë kur sintagma është e përbërë nga një emër i përveçëm. Arsyeja pse në gjuhën shqipe shndërrimi i NP në DP mund të bëhet vetëm nëpërmjet të lidhjes e jo edhe nëpërmjet të zhvendosjes është e parapërcaktuar me shkallën e gramatikalizimit të nyjës shquese në gjuhën shqipe. Nëpërmjet analogjisë përdorimi i saj është shtrirë pa përjashtim edhe tek emrat e përveçëm<sup>17</sup>, prandaj edhe sikur (kushtimisht) të bëhet zhvendosja e NP (p. sh. emrit të përveçëm) në pozicionin D, pa praninë e nyjës ajo nuk mund të kualifikohet për të kryer funksionin e kryefjalës gjegjësisht të shndërrohet në DP.

Edhe në gjuhën gjermane shndërrimi mund të bëhet nëpërmjet lidhjes, sepse edhe gjermanishtja ka nyja. Mirëpo jo gjithnjë ky shndërrim është i mundshëm nëpërmjet lidhjes, sepse siç u tha, te emrat e përveçëm nyja rregullisht mungon<sup>18</sup>. Rrjedhimisht, në këtë rast shndërrimi nga NP në DP nuk mund të bëhet nëpërmjet lidhjes, por vetëm nëpërmjet zhvendosjes. Sipas Longobardit (1994), zhvendosja e NP në pozicionin D në gjuhët të cilat nuk kanë nyja me emrat e përveçëm bëhet rregullisht, sepse (përveç të tjerave) ky pozicion nuk është i zaptuar nga nyja. Kështu ndodh edhe te gjuha gjermane, te e cila emri i përveçëm nga pozicioni më i ulët sintaksor NP, ngjitet në pozicionin më të lart sintaksor D, me ç'rast NP shndërrohet në DP. Duke kaluar në këtë pozicion dhe duke fituar statusin sintaksor për marrjen e funksioneve, emri i përveçëm "kualifikohet" edhe për tu lakuar<sup>19</sup>. Se (eventualisht) kështu ndodh, flet edhe dëshmia se mbarsa -s e gjinore nuk paraqitet nëse emri i përveçëm paraprihet nga nyja proklitike<sup>20</sup>:

- |     |                                    |                                 |
|-----|------------------------------------|---------------------------------|
| (7) | a. <u>Memos</u> Aufstieg           | (Ngritja e Memos) <sup>21</sup> |
|     | b. der Aufstieg des Memo-Ø         | (Ngritja e Memos)               |
|     | c. * der Aufstieg des <u>Memos</u> |                                 |

Një skenar i mundshëm i arsyes së mosparaqitjes së mbarsës (-s) në (7b) mund të jetë prania e nyjës proklitike (*des*) para emrit të përveçëm, e cila e zaptton pozicionin D, duke e pamundësuar zhvendosjen e emrit të përveçëm në këtë pozicion. Prandaj në këtë situatë, për tu shndërruar në DP, emri i përveçëm është i detyruar ta bëjë këtë nëpërmjet lidhjes, e jo zhvendosjes. Në këtë

---

është e mundshme që nyja të mungon: *Mit diesem Kabel Sie können (ein) Computer und (ein) Drucker verbinden (Me këtë kabllo ju mund të lidhni (një) kompjuter dhe (një) shtypës ndërmjet veti.)*. Në gjuhën gjermane këta shembuj konsiderohen si përdorim eliptik i sintagmës emërore (DUDEN 2016: 902). Meqë të gjithë shembujt të cilët Çeliku jep si dëshmi (kur kryefjala mund të jetë një emër pa nyja apo pa ndonjë përcaktor) përfshijnë drejtpërdrejt apo tërthorazi më shumë se një emër, unë besoj se këto janë gjithashtu raste sikurse ato të gjuhës gjermane, pra një përdorim eliptik i sintagmave emërore, të disa emrave të renditur pa nyjën (jo) shquese.

<sup>17</sup> Demiraj (1986: 301)

<sup>18</sup> Ndryshe qëndron puna te të folmet dialektore ku nyja e shquar është e pranishme rregullisht edhe me emrat e përveçëm. Shiko rreth kësaj çështje Gallman (1997)

<sup>19</sup> Shiko Gallman (1997:72), i cili për emrat e përveçëm të gjuhës gjermane thotë: "The inflectional behavior of the proper names themselves and the one of the articles and the adjectives connected with them depends on whether N° substitutes D° or is adjoined to D° as well as whether an agreement relation exists between SpecDP and D° with respect to morphosyntactical features".

<sup>20</sup> Shiko Eisenberg (2013:144), i cili thotë: "Das Genitiv-s kann nicht stehen, wenn der Eigename dem Artikel folgt". (Gjinorja -s nuk mund të qëndron nëse emri i përveçëm i prapavihet nyjës. Përkthimi nga T.A.) por edhe Schäfer (2016:272) dhe shembujt e paraqitur aty.

<sup>21</sup> Emrat e përveçëm në gjinore të gjuhës gjermane mund të shfaqen para (7a) dhe pas emrit (7b), prandaj edhe përkthimi i tyre në gjuhën shqipe del i njëjtë. Gjithashtu, nëse gjinorja shënon kuptim përkatësie, ajo mund të shprehet edhe me anë të parafjalës von: *Der Aufstieg von Memo (Ngritja e Memos)*.

mënyrë, duke marr parasysh këto fakte dhe strukturën në (6), struktura e konstruksioneve me ndajshim merr formën e njëjtë në të dy gjuhët:

- (8) a.  $[\text{NP}_\emptyset] + [\text{DP}_{\text{NOM}}]$  (për gjuhën shqipe), dhe  
 b.  $[\text{NP}_\emptyset] + [\text{DP}_{\text{NOM}}]$  (për gjuhën gjermane)

Në këtë rast pra, konstatimi i Uhlisch është i drejtë.

Te konstruksionet ndajshimore të paveçuar, varësisht nga situata bisedimore, rolet e gjymtyrëve mund të ndërrojnë:

- (9) a. Ky është komisarit *Memo*. Dies ist der Kommissar *Memo*. (NOM)  
 b. Një propozim i komisarit *Memo*. Ein Vorschlag des Kommissars *Memos*. (GEN)  
 c. Ne i besojmë komisarit *Memo*. Wir vertrauen dem Kommissar *Memo*. (DAT)  
 b. Ne e përjashtuam komisarin *Memo*. Wir verjagen den Kommissar *Memo*. (AKK)  
 d. Këtë se prisnim prej komisarit *Memo*. (ABL)

ashtu që emri i përgjithshëm bëhet emër bosht, ndërsa emri i përveçëm bëhet ndajshim (si në (9)). Në këtë situatë, folësi dëshiron të vë në dukje funksionin që kryen një njeri, pra ai që kryen funksionin e komisarit (e jo ta zëmë komandantit), i cili quhet *Memo*. Sipas Gramatikës së Akademisë (2002:239) emri bosht, si gjymtyrë e rangut më të lartë se ndajshimi, theksohet dhe merr nyjën e shquar. Prandaj (në shembujt e gjuhës shqipe) në (9) lakohet emri i përgjithshëm komisar, kurse emri i përveçëm nuk lakohet fare dhe shfaqet në të gjitha rasat me formën e emërores së pashquar gjegjësisht pa rasë. Rrjedhimisht, kemi një relacion morfo-sintaksor të kundërt me atë në shembullin (4). Lidhur me këtë veçanti të konstruksioneve ndajshimore, Beci (2005:215) propozon që kjo madje të jetë një provë për të vërtetuar "se cili nga dy emrat e pranëvënë kryen funksionin e ndajshimit". Për këtë arsye struktura e shembujve të gjuhës shqipe edhe në këtë rast mbetet e njëjtë:

- (10)  $[[\text{NP}_{\text{NOM}} + \text{DET}_{\text{NOM}}] + [\text{NP}_\emptyset]] = [\text{DP}_{\text{NOM}} + \text{NP}_\emptyset]$

ajo edhe pas ndërrimit të roleve ndërmjet emrit të përveçëm dhe emrit të përgjithshëm është e përbërë nga një sintagmë determinative dhe një sintagmë emërore.

Në një situatë të ngjashme edhe në gjuhën gjermane emri i përgjithshëm mund të bëhet emër bosht, mirëpo për ta bërë këtë atij i duhet nyja shquese (*der*) si në rrafshin semantik ashtu edhe në rrafshin sintaksor. Prandaj, në (9) para emrit *Kommissar* shfaqet nyja shquese, e cila mungonte në (4). Ngjashëm si folësi i gjuhës shqipe edhe folësi i gjuhës gjermane e thekson emrin e përgjithshëm dhe dëshiron të vë në dukje profesionin e një personi, i cili quhet *Memo*. Mirëpo, për dallim nga gjuha shqipe, emri i përveçëm *Memo* në gjinore vazhdon ta ketë mbaresën e gjinore (-s)<sup>22</sup>, që do të thotë se ai vazhdon të lakohet edhe pse ai ka humbur statusin e vet si bartës i funksioneve sintaksore. Rrjedhimisht, meqë nuk ka një përpara, ai përsëri zhvendoset në pozicionin sintaksor D. Mbështetur nga kjo që u tha më sipër, konstruksionet ndajshimore në gjuhën gjermane në (9) kanë këtë strukturë:

- (11) a.  $[[\text{DET}_{\text{NOM}}] + [\text{NP}_{\text{NOM}}]] + [\text{DP}_{\text{NOM}}] = [[\text{DP}_{\text{NOM}}] + [\text{DP}_{\text{NOM}}]]$  (për gjuhën gjermane)

<sup>22</sup> Sipas Eisenberg (2013: 259), te këto lloj konstruksionesh të dy gjymtyrët duhet të kenë rasë të njëjtë.

Nëse krahasojmë strukturën e gjuhës gjermane (11a) dhe strukturën e gjuhës shqipe (11b) të konstruksioneve ndajshtimore në (9) vërejmë se dallimi në strukturë është evident: struktura në gjuhën gjermane përbëhet nga dy sintagma determinante në të njëjtën rasë, kurse struktura në gjuhën shqipe përbëhet nga një sintagmë determinante në një rasë përkatëse dhe nga një sintagmë emërore pa rasë. Gjithashtu, dallimi është i dukshëm edhe në rrafshin morfologjik: në gjuhën gjermane lakohen të dy gjymtyrët e konstruksionit, kurse në gjuhën shqipe vetëm njëra. Dallim nuk ka vetëm në rrafshin pragmatiko-semantik, ku qëllimi i folësit të gjuhës gjermane dhe gjuhës shqipe është i njëjtë. Mirëpo, dallimi në rrafshin sintaksor e morfologjik na lë të konstatojmë se pohimi i Uhlisch nuk është i drejtë.

#### 4. A mund të jetë ndajshtim në gjuhën shqipe edhe emri i përveçëm

Këtu po themi se jo të gjithë gjuhëtarët shqiptarë janë të pajtimit me faktin se edhe emri i përveçëm mund të jetë ndajshtim. Për dallim nga gramatika e Akademisë (2002:239) dhe të gramatikave të disa gjuhëtarëve të tjerë shqiptarë si Beci (2005: 75) dhe Dhima (2005: 106), sipas të cilëve edhe emri i përveçëm mund të jetë ndajshtim, Çeliku (2012) e përjashton një mundësi të tillë. Ai në faqen 203 të sintaksës së tij i sheh konstruksionet ndajshtimore të cilat emri i përveçëm është ndajshtim, siç janë p. sh. *komesari Memo* apo *komandanti Rrapo*, si luhatje nga norma e gjuhës shqipe, pavarësisht se këto konstruksione janë përdorur nga autorë të mirënjohur siç është ta zëmë Dritëro Agolli<sup>23</sup>. Madje po aty, ai pohon: "në gjuhën standarde që përdoret në Kosovë ky grup emrash priret drejt zgjerimit edhe me ndonjë tjetër..." dhe merr shembujt me konstruksionet ndajshtimore:

(12) Sot na nderon me pjesëmarrjen e tij **profesori Mahir**, dhe  
**Nëna Terezë** është shqiptare.

Një përjashtim i tillë i Çelikut është i papritur dhe i habitshëm, meqë ai pretendon të përfshijë në analizën sintaksore të përbërësve të fjalisë edhe thënien. Pra, të përfshijë në këtë analizë edhe aspektin pragmatik të fjalisë, ku intonacioni ka një rëndësi të veçantë në aktualizimin e thënies. Mirëpo, duke tentuar që, sipas tij të mbrojë "normën dhe traditën e gjuhës shqipe", ai në shembujt e mësipërm nuk merr parasysh pikërisht aspektin pragmatik.

Një përjashtim i tillë i Çelikut mund të mos përkon as me rrjedhat aktuale rreth strukturës informative apo (siç e quan Çeliku) thënies së fjalisë, sepse në disa hulumtime të bëra së fundmi thuhet se informata e re lidhet pikërisht nëpërmjet të entiteteve. Kështu Krifka (2006:31) konstaton se në shembujt si:

<sup>23</sup> Është interesant se Çeliku (2012) nuk heziton aspak të përvetëson si gramatikisht korrekte edhe raste mjaft diskutabile për normën dhe traditën e gjuhës shqipe siç e përmendëm në fusnotën 16 të këtij punimi ("në situata të caktuara ligjërimore edhe një emër i pashquar pa nyje joshqese mund të jetë përbërës sintaksor"). Mirëpo, në sintaksën e tij ai jo rrallë herë e befason lexuesin me supozime tërësisht të kundërta me autorët e tjerë të librave gramatikor, siç është edhe ky rast, pra kur një emër i përveçëm merr rolin e ndajshtimit në vend të emrit të përgjithshëm, të cilën mundësi ai e përjashton.



- (13) a. Obama takoi Putin  
b. Putin takoi Obamën

ndonëse kuptimisht të njëjtë (sepse shprehin po të njëjtin propozim) ata megjithatë dallojnë. Shembujt janë të strukturuar ndryshe, sepse (11a) regjistrohet si një informatë që lidhet me Obamën, kurse (11b) me Putin. Mbase në këtë mënyrë mund të shpjegohet edhe nevoja e shkëmbimit të roleve ndërmjet emrit të përveçëm me atë të përgjithshëm (nga *komisar Memoja* në *komisari Memo*). Pra, një shpjegim bukur i ngjashëm me shpjegimin e Gramatikës së Akademisë, të cilin e shënuam më lartë.

Në gramatikat e gjuhës gjermane dilema se a është emër bosht emri i përgjithshëm apo emri i përveçëm nuk është e pranishme. Te këto gramatika vëmendja është më shumë e përqendruar në devijimin e formës së ndajshtimit dhe fjalës bosht, varësisht se a është e pranishme nyja shquese te emri i përgjithshëm. Sipas DUDEN (2016: 990) kur emri i përgjithshëm është ndajshtim dhe ai shënon një titull si: *Komissar Memo (komisari Memo)apo, Profesorin Nita (profesoresha Nitë)*etj. ai nuk shoqërohet nga nyja. Por, kur këta emra si ndajshtim nuk shënojnë tituj, atëherë ata shoqërohen me nyja:

- |   |  |
|---|--|
| (14) a. die Begegnung Merkel-Obama      | takimi Merkel-Obama                    |
| b. die Rechtsanwältin Sabine Tessendorf | avokatja Sabine Tessendorf             |
| c. der berühmte Kammersänger Ronald     | këngëtari i famshëm i kantantes Roland |

Sipas Eisenberg (2013: 257) një numër i konsiderueshëm i konstruksioneve ndajshtimore përbëhen nga dy sintagma determinante në të njëjtën rasë: [DP+DP]<sup>24</sup>.

Në vazhdim do të shohim se si qëndron puna me strukturën e konstruksioneve ndajshtimore të gjuhës shqipe, të cilat, sipas disa gjuhëtarëve, shfaqen edhe në rasë të tjera, sidomos në gjinore dhe rrjedhore. Rrjedhimisht, do të analizojmë se ç'strukturë kanë këto konstruksione gjegjësisht a përbëhet edhe struktura e tyre në këto raste nga një sintagmë determinante dhe një sintagmë emërore. Mirëpo, para se të vazhdojmë me këtë analizë, ne do ti shpalosim dy veti të përgjithshme të ndajshtimit, të cilat eventualisht do të na ndihmojnë për të analizuar këto konstruksione.

<sup>24</sup>Këtu po japim një vërejtje lidhur me këtë formulë sintaksore: ajo nuk mund të aplikohet në të gjitha konstruksionet ndajshtimore, sepse jo në të gjitha rastet fjala bëhet për dy sintagma. Kështu p. sh. në gjuhën gjermane te konstruksionet e ashtuquajtura ndajshtime eksplikative: *die Stadt Rom (qyteti Romë)*. Te ky shembull struktura nuk është DP + DP, por DP + N, sepse elementi i dytë i këtij konstruksioni nuk është sintagmë, sepse ajo nuk mund të zgjerohet me ndonjë përcaktorë: \* *die Stadt schönes Rom*. Këto lloj ndajshtimesh gjithashtu kanë një renditje të ngulitur, e cila nuk mund të ndryshohet pa e ndërruar tipin e ndajshtimit, nga i paveçuar në ndajshtim të veçuar: \**Rom die Stadt/Rom, die Stadt (\*Roma qytet)*. Ngjashëm është edhe në gjuhën shqipe. Krahaso p. sh. *Lumi Vjosë/ \*Lum Vjosa*. Edhe te ndajshtimet eksplikative të gjuhës shqipe nuk mund të aplikohet formula DP+NP, por DP+N, sepse gjymtyra e dytë e konstruksionit nuk është sintagmë por një emër i përveçëm. Edhe në gjuhën shqipe renditja është e ngulitur. Si konkluzion i kësaj që u parashtrua në këtë fusnotë mund të themi: disa konstruksione të ashtuquajtura ndajshtimore eksplikative, sidomos ato që kanë një renditje të ngulitur, në gjuhën gjermane dhe gjuhën shqipe kanë strukturë dhe formë të njëjtë. Rrjedhimisht, edhe te këto konstruksione pohimi i Uhlisch është i drejtë.

## 5. Dy veti të konstruksioneve ndajshtimore

Siç i përmendëm edhe më lartë, ko-referenca dhe lidhja predikative janë dy veti të përgjithshme të konstruksioneve ndajshtimore. Në vijim do ti provojmë të dy këto veti në konstruksionet ndajshtimore të dy gjuhëve. Vetia e ko-referencës mundëson që njëri nga elementet e konstruksionit të hiqet fare dhe shprehja (e mbetur) të jetë prapëseprapë gramatikisht dhe semantikisht korrekte<sup>25</sup>.

- (15) a. Profesoresha Nitë kujton ... Die Professorin Nita meint ...  
 b. Profesoresha ime kujton ... Die Professorin meint ...  
 c. \*Nitë/ Nita kujton ... Nita meint ...

Konkretisht, kur konstruksionit ndajshtimor në (15a) ia heqim ndajshtimin (*Nitë*), shprehja e mbetur (15b) në të dy gjuhët gramatikisht është korrekte dhe i referohet po të njëjtit person si në (15a). Gjithashtu, kur shembullit (15a) ia heqim emrin bosht (*profesoreshë*), shprehja e mbetur (Nitë + nyja shquese e gjinisë femërore -a, e cila pas heqjes së emrit bosht tani mbetet në dispozicion për t'iu bashkuar ndajshtimit *Nitë*) gramatikisht gjithashtu është korrekte. Edhe (15c) i referohet po të njëjtit person si (15a), që do të thotë se sikurse (15b), edhe kjo semantikisht është korrekte. Zëvendësimi i njëres gjymtyrë nga tjetra për të verifikuar ko-referencën nënkupton gjithashtu që gjymtyra e cila e zëvendëson një gjymtyrë tjetër duhet të merr përsipër edhe ushtrimin e po të njëjtave funksione sintaksore. Thënë ndryshe, me ko-referencë në këtë punim do të nënkuptojmë se gjymtyrët janë ko-identike si në rrafshin semantik ashtu edhe në rrafshin.

Të shohim tani se si qëndron puna me strukturën sintaksore.

- (16) a. profesoresh-a Nitë [NP<sub>∅</sub> + DET<sub>NOM</sub>] + [NP<sub>∅</sub>] = [DP<sub>NOM</sub>] + [NP<sub>∅</sub>]  
 a'. Nit-a [NP<sub>∅</sub> + DET<sub>NOM</sub>] = [DP<sub>NOM</sub>]  
 b. i/e profesoresh-ës Nitë i/e [NP<sub>∅</sub> + DET<sub>GEN</sub>] + [NP<sub>∅</sub>] = i/e [DP<sub>GEN</sub>] + [NP<sub>∅</sub>]  
 b'. i/e Nit-ës i/e [NP<sub>∅</sub> + DET<sub>GEN</sub>] = i/e [DP<sub>GEN</sub>]  
 c. profesoresh-ës Nitë [NP<sub>∅</sub> + DET<sub>DAT</sub>] + [NP<sub>∅</sub>] = [DP<sub>DAT</sub>] + [NP<sub>∅</sub>]  
 c'. Nit-ës [NP<sub>∅</sub> + DET<sub>DAT</sub>] = [DP<sub>DAT</sub>]  
 d. profesoresh-ën Nitë [NP<sub>∅</sub> + DET<sub>AKK</sub>] + [NP<sub>∅</sub>] = [DP<sub>AKK</sub>] + [NP<sub>∅</sub>]  
 d'. Nit-ën [NP<sub>∅</sub> + DET<sub>AKK</sub>] = [DP<sub>AKK</sub>]  
 e. profesoresh-ës Nitë [NP<sub>∅</sub> + DET<sub>ABL</sub>] + [NP<sub>∅</sub>] = [DP<sub>ABL</sub>] + [NP<sub>∅</sub>]  
 e'. Nit-ës [NP<sub>∅</sub> + DET<sub>ABL</sub>] = [DP<sub>ABL</sub>]

Siç vërehet në (16), zëvendësimi i emrit bosht nga ndajshtimi (16a'-e') mund të ndodh pavarësisht se në cilën rasë është emri bosht, sepse ndajshtimi është në emëroren e pashquar [NP<sub>∅</sub>], me tiparin rasor [∅]. Mu ky tipar është qenësor për vetinë e ko-referencës në rrafshin sintaksor. Duke qenë se ndajshtimi është pa rasë, ai tani mund të merr rasën e fjalës bosht dhe në këtë mënyrë të aftësohet për të kryer edhe funksionet sintaksore (kryefjalë, kundrinë apo përcaktor) të realizuara më parë nga emri bosht.

Në (15) vërejmë se edhe në gjuhën gjermane ndajshtimi mund të largohet (15b) pa shkaktuar ndonjë parregullsi në rrafshin semantik e sintaksor. Gjithashtu vërejmë se kur

<sup>25</sup> Lidhur me këtë çështje shiko Hentschel & Weidt (1994:360)

zëvendësohet emrit bosht nga ndajshtimi (15c) shprehja ende i referohet po të njëjtit person si në (15a) dhe (15b). Të shohim tani se ç'ndodh te kjo gjuhë në rrafshin sintaksor.

- |      |                                |   |
|------|--------------------------------|---|
| (17) | a. <b>Memo</b> der Kommissar   | [DP <sub>NOM</sub> ] + [DP <sub>NOM</sub> ] |
|      | b. <b>Memos</b> des Kommissars | [DP <sub>GEN</sub> ] + [DP <sub>GEN</sub> ] |
|      | c. <b>Memo</b> dem Kommissar   | [DP <sub>DAT</sub> ] + [DP <sub>DAT</sub> ] |
|      | d. <b>Memo</b> den Kommissar   | [DP <sub>AKK</sub> ] + [DP <sub>AKK</sub> ] |

Meqë sipas rregullës të gjuhës gjermane emri bosht (*Memo*) dhe ndajshtimi (*der Kommissar*) duhet të jenë në rasi të njëjta, atëherë kur në (17a-d) e zëvendësojmë emrin bosht me ndajshtimin, ky i fundit (për shkak se është në rasi të njëjtë) mund të marrë të gjitha funksionet sintaksore të të parit. Sikur emri bosht dhe ndajshtimi mos të ishin në të njëjtën rasi, atëherë një zëvendësim i tillë në rrafshin sintaksor nuk do të ishte i mundshëm.

Konstruksionet ndajshtimore në gjuhën shqipe dhe gjermane (18a):

- |      |                         |                   |
|------|-------------------------|-------------------|
| (18) | a. komisar Memoja       | Komissar Memo     |
|      | b. memoja është komisar | Memo ist Komissar |

kanë edhe vetinë e lidhjes predikative, me ç'rast emri bosht dhe ndajshtimi lidhen nëpërmjet foljes këpujore (18b). Siç u tha edhe më lartë, disa gjuhëtarë preferojnë këtë veti para ko-referencës, për të potencuar se kjo e fundit mund të jetë vetëm si një rrjedhojë e kësaj lidhje.

## 6. A ka ndajshtim në rasi gjinore dhe rrjedhore në gjuhën shqipe

Në vijim do të përdorim këto dy veti si kritere për të provuar se a ka gjuha shqipe ndajshtime të paveçuar, të cilat mund të jenë edhe në rasi të tjera përveç në rasi emërore të pashquar. Arsyeja për të hyrë një prove të tillë është se disa gjuhëtarë, si p. sh. Prifti (1971:101) Prifti (1977: 54), Demiraj (1986:542) por edhe Buchholz/Fiedler (1987: 424), mendojnë se si ndajshtim mund të paraqiten edhe një emër në gjinore, nëse ai shënon emra gjeografik, emra të muajve apo ditëve si p. sh.

- (19) Mali *i Dajtit*, Qyteti *i Korçës*, Muaji *i marsit*, dita e diel

Arsyeja e përfshirjes së emrit në gjinore si ndajshtim nga ana e këtyre gjuhëtarëve me gjasë është se këto konstruksione siç duket janë shumë të hershme në gjuhën shqipe dhe se gjymtyrët mund të nënkuptohen si ko-referente gjegjësisht supozohet se konstruksionet ndajshtimore në gjinore (në rrafshin semantik) janë identike me konstruksionet ndajshtimore në emërore të pashquar :

- (20) Mali *Dajt*, Qyteti *Korçë*, Muaji *mars*

Të fillojmë me rrafshin semantik. Siç u tha, është fakt se te këto ndërtime emri bosht dhe emri ndajshtimor mund të referohen njëri tjetrit, mirëpo është po ashtu fakt se te këto konstruksione kriteri i lidhjes predikative realizohet me vështirësi:

- (21) Mali është *i Dajtit*, Qyteti është *i Korçës*, Muaji është *i marsit*.

Kjo vështirësi është sidomos evidente te disa konstruksione me ndajshtim në gjinore, te të cilat janë të pranishëm po ashtu emrat gjeografikë në gjinore, si p. sh.

- (22) a. Lumi *i Osumit*, Fshati *i Kleçkës*  
b. #Lumi është *i Osumit*, Fshati është *i Kleçkës*

Siç duket folësi shqiptar nuk preferon konstruksionet (22a) si ekuivalencë të konstruksioneve *lumi Osum. lumi Vjosë* përkatësisht *fshati Pasjan, fshati Kleçkë*, sepse po të hedhim një shikim në internet (google) shumë më shpesh shfaqet<sup>26</sup>:

- (23) a. Lumi *Osum* del nga shtrati<sup>27</sup>, se sa  
b. \* Lumi *i Osumit* del nga shtrati,  
(24) a. Fshati *Kleçkë* kërkon ndihmë që sa më shpejt të bëjë hapjen e rrugës<sup>28</sup> ..., se sa  
b. \* Fshati *i Kleçkës* kërkon ndihmë që sa më shpejt të bëjë hapjen e rrugës

Gjithashtu, shembujt si (25a) dhe (25b) mund të kanë kuptime të ndryshme.

- (25) a. Katundi *Kabash*  
b. Katundi *i Kabashit*

Interpretimi i (25b) mund të jetë i dyfishtë. Në rastin e parë, ai mund të jetë identik me interpretimin e shembullit (25a), kurse në rastin e dytë fjala mund të jetë për katundin e personit që ka mbiemrin *Kabashi*, e që jo domosdoshmërisht duhet të jetë *katundi Kabash*, sepse ky person mund të jeton apo të jetë i lindur ta zëmë në katundin *Shkretë* ose ndonjë tjetër. Por, nëse thuhet *katundi Kabash*, atëherë ky shembull mund të ketë vetëm një kuptim. Ngjashëm mund të jetë edhe me shembujt:

- (26) Qyteti *i Vlorës*, apo qyteti *i Milotit* etj.

Te këta shembuj dhe shembuj të ngjashëm (sidomos në Kosovë ku mjaft individë mbajnë emra gjeografik) vetëm konteksti apo informata shtesë mund ti hejë "mëdyshjet" e dëgjuesit se a është fjala për qytetin ku jetojnë apo ku janë lindur personat *Vlorë* përkatësisht *Milot* apo për qytetin *Vlorë* përkatësisht *Milot*. Ndërkaq mëdyshje të tilla te shembujt: *qyteti Vlorë* ose *qyteti Milot* nuk janë fare e pranishme.

Arsyeja e dytë është se shembujt në (27) dhe (28) kanë struktura të ndryshme:

- (27) a. Mali *i Dajtit*, Qyteti *i Korçës*, Muaji *i marsit*  
b. [NP<sub>∅</sub>+DET<sub>NOM</sub>] + i [NP<sub>∅</sub>+DET<sub>GEN</sub>] = [DP<sub>NOM</sub>] + i [DP<sub>GEN</sub>]

<sup>26</sup> Lidhur me përdorimin e internetit në mbledhjen e fakteve në gjuhësi shiko Gato (2014:101), sipas së cilës: " There seems to be clear evidence that, in spite of its limitations, the web can be used as a reliable source of quantitative and qualitative evidence of usage.." (Duket e qartë se përkundër kufizimeve, interneti (WEB) mund të përdoret si burim kuantitativ dhe kualitativ. i evidencës së përdorimit..Përkthyer nga T. A.)

<sup>27</sup> Më 29/12/2017 në ora 13.55, gjatë hulumtimit në google rezultati ishte: 29 800 herë u shfaq sintagma emërore *Lumi Osum*, kurse *lumi i Osumit* 2650 herë.

<sup>28</sup> Më 29/12/2017 në ora 14.00, gjatë hulumtimit në google rezultati ishte: 542 u shfaq sintagma emërore *fshati Kleçkë*, kurse vetëm 1 (një) herë sintagma *fshati i Kleçkës*.

- (28) a. Mali *Dajt*, Qyteti *Korçë*, Muaji *mars*  
 b.  $[NP_{\emptyset} + DET_{NOM}] + [NP_{\emptyset}] = [DP_{NOM}] + [NP_{\emptyset}]$

Struktura e konstruksioneve ndajshtimore me gjinore (27a), përbëhet nga një sintagmë determinante në emërore dhe një sintagmë determinante në gjinore (27b), kurse struktura e konstruksioneve ndajshtimore me emërore të pashquar (28a) përbëhet nga një sintagmë determinante dhe një sintagmë emërore pa mbaresë rasore (28b). Është evidente se struktura (27b), e përbërë nga dy sintagma determinante, i ngjanë strukturës ndajshtimore të gjuhës gjermane me ndajshtim në emërore të pashquar. Pra, kjo strukturë devijon nga struktura e zakonshme e konstruksioneve ndajshtimore në gjuhën shqipe dhe së paku për dy arsye mbetet e paqartë se si në situatat kur fjala bosht zëvendësohet nga ndajshtimi, ky i fundit mund të merr funksionet sintaksore e të parit. E para, emri ndajshtimor në (27a) ka të prapavendosur nyjën në gjinore dhe një sintagmë e tillë determinante nuk mund të merr funksionin sintaksor që ka fjala bosht, siç është p. sh. kryefjala apo kundrina, pasi që sintagma determinante në gjinore nuk mund të kryen asnjërën nga këto funksione sintaksore. E dyta, pasi që të hiqet emri bosht p. sh. *mal*, në strukturë mbetet ende e pranishme nyja e shquar e gjinisë mashkullore -i ( $DET_{NOM}$ ), ashtu që struktura e mbetur është:

- (29) [-i] [i Dajt-it]  $[DET_{NOM}] + i [DP_{GEN}]$

Pra, struktura sintaksore nuk përbëhet vetëm nga sintagma determinante në gjinore  $DP_{GEN}$ , por ajo ka edhe një nyje të shquar ( $DET_{NOM}$ ), e mbetur nga emri bosht. Në këtë mënyrë, kjo strukturë si e tillë, jo vetëm që s'mund të merr ndonjë funksion gramatikor të emrit bosht, por ajo edhe gramatikisht është jo korrekte. Natyrisht në (27) dhe (28) është paraqitur konstruksioni dhe struktura përkatëse vetëm në emërore. Për shkak të hapësirës nuk po paraqesim edhe rasët e tjera, por të kihet parasysh se edhe strukturat në rase të tjera janë të ngjashme: ndajshtimi te ato s'mund të merr ndonjë funksion sintaksor dhe shprehjet mbesin gramatikisht jo korrekte nëse zëvendësohet fjala bosht me ndajshtimin.

Si përfundim mund të nxjerrim: ndajshtimi në gjinore për disa arsye mund të konsiderohet si çështje problematike: (i) ai jo gjithnjë i referohet emrit bosht, (ii) konstruksionet ndajshtimore me emërore të pashquar nuk janë gjithnjë semantikisht ekuivalente me konstruksionet ndajshtimore në gjinore dhe (iii) në rast të heqjes së emrit bosht, ndajshtimi në gjinore nuk mund të merr funksionet sintaksore të këtij të fundit. Prandaj, në pyetjen e shtruar se a ka në gjuhën shqipe konstruksione ndajshtimore me gjinore si përgjigje po japim atë që thotë Gramatika e Akademisë (2002:227): emri në rasën gjinore kur është në trajtë të shquar "funksionon vetëm si përcaktor" pa lënë mundësi që ai të jetë ndajshtim.

Lidhur me dilemën se a ka konstruksione ndajshtimore në gjuhën shqipe me ndajshtim edhe në rasë të tjera përveç në emërore të pashquar, pohimi i Friedman (2006:663) del i paqartë. Ai në artikullin e tij enciklopedik *Balkans as Linguistic Area*, kur flet për funksionet e rasave të gjuhës shqipe thotë:

"... the ablative is the object of certain prepositions or in apposition to another substantive". (Rrjedhorja është kundrinë e disa parafjalëve ose ndajshtim i një emri tjetër. Përkthyer nga T. A.)

Konstatimi i Friedmanit është sa i papritur aq edhe i habitshëm, sepse edhe sikur të ekzistonte mundësia që rrjedhja të shfaqet në funksion të ndajshtimit ashtu siç e përmend përciptazi dhe e supozon Prifti (1977: 54), një shfaqje e tillë është e pa përfillshme në krahasim me shfaqjen e rrjedhës në funksion të përcaktorit. Mirëpo, është një çështje tjetër nëse Friedman pretendon (kështu së paku lë të kuptohet) se emri në rrjedhore, që shkon pas një emrit tjetër, funksionon si ndajshtim e jo si përcaktor. Prandaj në vijim, duke marrë parasysh vetitë e konstruksioneve ndajshtimore të shtruara më sipër dhe duke përdorur një analizë të njëjtë, do të provojmë se a është një pohim i tillë i drejtë.

- (30) a. natë *dimri/vere/pranvere/vjeshte/janari* etj.  
 b. lule *qershie/vere/mali* etj.  
 c. lëvizje *njerëzish/gurësh/aeroplanësh/ ushtarakësh/policësh* etj.

Nëse supozojmë se konstruksionet në (30) janë ndajshtimore dhe nëse te këto konstruksione e largojmë emrin bosht *natë*, *lule* apo *lëvizje*, atëherë për shkak të vetisë së ko-referencialitetit

- (31) a. *dimri/vere/pranvere/vjeshte/janari* etj.  
 b. *qershie/vere/mali* etj.  
 c. *njerëzish/gurësh/aeroplanësh/ ushtarakësh/policësh* etj.

emrat e mbetur në (31a) ishte dashur ti referoheshin *natës*, emrat në (31b) *lules*, kurse në (31c) *lëvizjes* dhe njëkohësisht të gjithë emrat në (31a) të jenë ko-referent, pra ti referohen njëri tjetrit. Njëllor ishte dashur të ishte edhe në (31b) dhe (31c). Mirëpo, meqë një gjë e tillë nuk është e mundshme, konkludojmë se konstruksionet në (30) nuk e kanë vetinë e ko-referencialitetit. Gjithashtu, meqë *nata* nuk është *dimër*, e as *verë*, *pranverë*, *vjeshtë* apo *janar*, si dhe *lulja* nuk është *qershie*, *verë* apo *mal* e kështu me radhë, mund të themi se konstruksionet në (30) nuk e kanë as vetinë e lidhjes predikative. Në fakt duke u çiftëzuar në një mënyrë të tillë, emrat që i shkojnë pas emrit bosht secilën herë shënojnë një entitet tjetër, duke modifikuar gjegjësisht kufizuar në këtë mënyrë shtrirjen e konceptit të shënuar nga emri bosht. Pra, duke bërë diçka që është tipike për një përcaktor e jo për një ndajshtim. Si përfundim mund të nxjerrim: në rrafshin semantik konstruksionet në (30) nuk e plotësojnë kriterin e ko-referencialitetit.

Të shohim tani se si qëndron puna në rrafshin sintaksor. Sipas Gramatikës së Akademisë (2002: 239) "emri në rrjedhore është gjithnjë i pashquar dhe varet nga gjymtyrë të shprehura me emër të pashquar ose me togfjalësh, fjala bosht e të cilit është një emër i pashquar". Duke marrë parasysh këtë përkufizim dhe konstruksionet në (30), struktura sintaksore ka këtë formë:

- (32) a. një lule mali            [[DET<sub>NOM</sub>] + [NP<sub>NOM</sub>]] + [NP<sub>ABL</sub>] = [DP<sub>NOM</sub>] + [NP<sub>ABL</sub>]  
 b. i një lule mali        i [[DET<sub>GEN</sub>] + [NP<sub>GEN</sub>]] + [NP<sub>ABL</sub>] = [DP<sub>GEN</sub>] + [NP<sub>ABL</sub>]  
 c. një lule mali            [[DET<sub>DAT</sub>] + [NP<sub>DAT</sub>]] + [NP<sub>ABL</sub>] = [DP<sub>DAT</sub>] + [NP<sub>ABL</sub>]  
 d. një lule mali            [[DET<sub>AKK</sub>] + [NP<sub>AKK</sub>]] + [NP<sub>ABL</sub>] = [DP<sub>AKK</sub>] + [NP<sub>ABL</sub>]  
 e. një lule mali            [[DET<sub>ABL</sub>] + [NP<sub>ABL</sub>]] + [NP<sub>ABL</sub>] = [DP<sub>ABL</sub>] + [NP<sub>ABL</sub>]

Nëse tani në (30) e largojmë emrin bosht:

(33)	a. *një mali	[DET <sub>NOM</sub> ] + [NP <sub>ABL</sub> ]	a'. një mal
	b.* i një mali	i [DET <sub>GEN</sub> ] + [NP <sub>ABL</sub> ]	b'. i një mali
	c.* një mali	[DET <sub>DAT</sub> ] + [NP <sub>ABL</sub> ]	c'. një mali
	d. *një mali	[DET <sub>AKK</sub> ] + [NP <sub>ABL</sub> ]	d'. një mal
	e. një mali	[DET <sub>ABL</sub> ] + [NP <sub>ABL</sub> ] = [DP <sub>ABL</sub> ]	e'. një mali

Në parim, nëse abstraktojmë sinkretizmat rasore dhe faktin se nyja jo shquese e shqipes i ka rrafshuar mbaresat rasore, atëherë ishte dashur që vetëm konstruksioni (33e) të ishte gramatikisht korrekt, sepse nyja jo shquese dhe sintagma emërore (që të dyja) janë në rrjedhore. Ndërkaq në rasat e tjera nuk ka kongruencë ndërmjet nyjës dhe sintagmës emërore në rrjedhore. Rrjedhimisht vetëm në (33e) sintagma determinante në rrjedhore ([DP]<sub>ABL</sub>) mund të merr funksionin sintaksor të emrit bosht. Por, nëse marrim parasysh edhe sinkretizmat dhe faktin se nyja jo shquese ka vetëm një formë në të gjitha rasat, atëherë duke krahasuar (33a-e) me (33 a'-e') emri në rrjedhore mund të merr eventualisht funksionet sintaksore të konstruksionit në gjinore, dhanore dhe rrjedhore, por jo edhe funksionet sintaksore të konstruksionit në emërore dhe kallëzore. Thënë ndryshe, konstruksioni nuk mund të kualifikohet si konstruksion ndajshtimor as në rrafshin sintaksor. Prandaj, si përfundim mund të nxjerrim se pohimi i Friedman nuk është i drejtë. Rrjedhimisht, në analizën tonë kontrastive nuk do të përfshihen konstruksionet e përmendura në rrjedhore dhe gjinore, por vetëm konstruksionet ndajshtimore me emërore të pashquar.

## 7. Konstruksionet ndajshtimore me përemra vetorë

Siç u përmend edhe më herët, fjalë bosht në konstruksionet ndajshtimore përveç emrit mund të jetë edhe një përemër vetor në veten e I-rë ose të II-të, mirëpo sipas gramatikës së Akademisë (2002: 239) ndajshtimi gjegjësisht emri që i vjen pas përemrit, për dallim kur fjala bosht është emër, shprehet në trajtë të shquar:

(34)	a. ne <i>gjuhëtar-ët</i> ...	NOM
	b. i neve <sup>29</sup> <i>gjuhëtarëve</i> ...	GEN
	c. neve <i>gjuhëtarëve</i> ...	DAT
	d. ne <i>gjuhëtarët</i>	AKK
	c. prej nesh <i>gjuhëtarëve</i>	ABL

Nëse përemrin *ne* e shënojmë *PRON*, atëherë struktura e shprehjes (34) në emërore do të ketë këtë formë:

(35)	$PRON_{NOM} [NP_{NOM} + DET_{NOM}] = PRON_{NOM} [DP_{NOM}]$
------	---

<sup>29</sup> Sipas Gramatikës së Akademisë (2002:222) rása gjinore e dy vetave të para në njëjës dhe shumës përdoret tepër rrallë dhe kjo ndodh zakonisht në gjuhën e folur kur aho është e ndjekur nga një ndajshtim.

Pra, ajo është e përbërë nga një përemër (PRON) dhe nga një sintagmë determinante në rasën përkatëse. Për dallim nga konstruksionet te të cilët fjala bosht është një emër dhe vetëm ky i fundit lakohej, te konstruksionet me përemra lakohen të dy gjymtyrët: fjala bosht (përemri) dhe ndajshtimi (emri).

Edhe në gjuhën gjermane fjala bosht mund të jetë përemër:

- |      |                                 |     |
|------|---------------------------------|-----|
| (36) | a. wir <i>Linguisten</i> ...    | NOM |
|      | b. unsere <i>Linguisten</i> ... | GEN |
|      | c. uns <i>Linguisten</i> ...    | DAT |
|      | d. uns <i>Linguisten</i> ...    | AKK |

Struktura e konstruksionit në emërore është e përbërë nga një përemër në emërore dhe një sintagmë emërore po ashtu në emërore, sepse në gjuhën gjermane kur emri shkon pas një përemri vetor kongruenca në rasë është e domosdoshme<sup>30</sup>:

- (37) [PRON<sub>NOM</sub> + NP<sub>NOM</sub>]

Nëse krahasojmë strukturën në gjuhën shqipe (35) dhe strukturën në gjuhën gjermane (37) vërejmë se dallimi ndërmjet tyre është evident dhe kjo është edhe një e dhënë, e cila e kundërshton pohimin e Uhlisch. Madje ky dallim është edhe më i thellë, sepse disa gjuhëtarë, duke u mbështetur në Postal (1969), por edhe te gjuhëtarë shumë më të hershëm<sup>31</sup>, kujtojnë se i tërë konstruksioni nuk është fare një konstruksion ndajshtimor, por është thjeshtë një sintagmë determinante e zakonshme. Sipas kësaj hipoteze, përemrat vetorë të vetës I-rë dhe të II-të janë të afërt me nyjat. Në konstruksionet e mësipërme të gjuhës gjermane, si dhe te konstruksionet e ngjashme në gjuhën angleze, përemrat shfaqin njëfarë ngjashmërie me këto të fundit si në rrafshin semantik, duke e kufizuar referencën, ashtu edhe në atë sintaksor, ngase nyja dhe përemri kanë distribuim të njëjtë:

- |      |                                   |               |
|------|-----------------------------------|---------------|
| (38) | a. die Linguisten/ wir Linguisten | (gjermanisht) |
|      | b. the linguists/ we linguists    | (anglisht)    |

Rrjedhimisht, këta gjuhëtarë i trajtojnë të dyja këto konstruksione si një njësi sintaksore të vetme gjegjësisht si një sintagmë<sup>32</sup>, e sidomos nëse kihet parasysh fakti se te këto konstruksione nyja dhe përemri janë në relacion konkurrues, që do të thotë se nuk mund të shfaqen të dyja në të njëjtën kohë:

- (39) a. \* wir die Linguisten  
b. \* we the Linguists

<sup>30</sup> Ndonëse për shkak të sinkretizmave mbaresat rasore në shembullin (36) janë të padukshme, pro krahaso:

(a) wir Europäer (NOM), für uns Europäer (AKK), von uns Europäern (DAT)

(b) mir altem Kerl (në krahasim me: mir alten Kerl); wir Arbeitslosen (në krahasim me: wir Arbeitslose) shiko DUDEN (2016:986)

<sup>31</sup> Si p. sh. Jakob Grimm (1837). Shiko më detalisht Vater (1998:11), por edhe Molitor (1979:122-137) si dhe literaturën e cituar aty.

<sup>32</sup> Shiko Molitor (1979:127)



Natyrisht, ky relacion konkurrues është i pranishëm vetëm te konstruksionet te të cilat përemri dhe ndajshtimi nuk janë të veçuar si në (38), por jo edhe te rastet kur janë të veçuar si në vijim :

- (40) a. wir, die Linguisten  
b. we, the Linguists

Thënë ndryshe, te konstruksionet (38) përemrat zënë vendin e nyjave në pemën sintaksore, prandaj mund të themi se PRON = DET. Nëse kemi parasysh këtë, atëherë struktura për gjuhën gjermane në (37) merr formën:

- (41) [PRON<sub>NOM</sub> + NP<sub>∅</sub>] = [DET<sub>NOM</sub> + NP<sub>∅</sub>] = [DP<sub>NOM</sub>]

Pra, struktura e konstruksioneve në gjuhën gjermane është thjeshtë një sintagmë determinante, kokë sintaksore e së cilës është një përemër vetor. Këtu po themi se ishte pikërisht kjo dukuri e konstruksioneve me përemra e emra, të cilën Abney (1987: 282-3) e përdori (së bashku me disa të dhëna të tjera empirike) për të ndërtuar të ashtuquajturën hipotezë DP, e cila supozon se nyja është kokë e sintagmës determinante, kurse emri është një komplement i saj<sup>33</sup>. Mirëpo nga ana tjetër, është pikërisht ky fakt që e shton dilemën se a ka në gjuhën gjermane konstruksione ndajshtimore, te të cilat përemri vetorë është fjalë bosht.

Për të hequr dilemat se a janë shprehjet e gjuhës shqipe (34) dhe shprehjet e gjuhës gjermane (36) konstruksione ndajshtimore, në vijim do të aplikojmë te këto konstruksione kriterin e ko-referencialitetit. Nëse në gjuhën shqipe e heqim fjalën bosht (përemrin), atëherë ndajshtimi (emri) pikërisht për shkak të pranisë së nyjës është i aftë të merr të gjitha funksionet sintaksore. Rrjedhimisht, në këtë rast prania e nyjës shquese te ndajshtimi ka një rol esencial në ndërtimin e konstruksioneve ndajshtimore me përemër. Por, nëse ndajshtimi që i shkon pas një përemri mund eventualisht të dal edhe si një emër në gjinore, siç pohon Gramatika e Akademisë (2002:239) dhe Beci (2005:215)<sup>34</sup> si në shembujt në vijim:

- (42) a. Ja shpëtova, si shpëtonim kurdoherë *ne të malit*.<sup>35</sup>  
b. Na ndihmoni edhe *ju të universitetit*.<sup>36</sup>

atëherë kriteri i ko-referencialitetit realizohet vetëm në rrafshin semantik, por jo edhe në rrafshin sintaksor, meqenëse ndajshtimi (në gjinore) nuk mund të merr të gjitha funksionet sintaksore të fjalës bosht. Një supozim i tillë, sidomos i Gramatikës së Akademisë, del i papritur sepse, siç thamë edhe më herët, po e njëjta gramatikë, në të njëjtin kapitull, në fq. 227, pohon se (po e përsërisim): "Emri në rasën gjinore funksionon vetëm si përcaktor, kur është në shumës ose në njëjës në trajtën e shquar". Edhe te shembujt (42a-b) emri në gjinore është në trajtë të shquar dhe

<sup>33</sup> Është e qartë se në gjuhën shqipe struktura e konstruksioneve me përemër nuk mund të përdoret për të mbështetur hipotezën DP, mirëpo kjo hipotezë mund të mbështetet edhe nga vet natyra e nyjës së shquar të shqipes, të përmendur edhe nga Cipoja (1952:22): " Nyjet kanë këtë të veçantë që munt të substantivojnë çfarëdo pjese të ligjeratës me përjashtim përemrit dhe foljes". Një natyrë e tillë lë të kuptojë se nyja mund të plotësoi kriteret për tu kualifikuar si kokë e sintagmës emërore. Lidhur më tutje për këtë çështje shiko Abrashi (2009).

<sup>34</sup> Këtë mundësi e jep edhe Dhima (2005: 106), por shembujt e Dhimës janë identik si shembujt e Gramatikës së Akademisë, pa dhënë ndonjë koment apo ndonjë informatë shtesë.

<sup>35</sup> Shembull i marr nga Gramatika e Akademisë (2002: 239)

<sup>36</sup> Shembull i marr nga Beci (2005: 215)

rrjedhimisht ishte dashur të kualifikoheshin si përcaktorë e jo si ndajshtim. Meqë nuk ka ndonjë shpjegim shtesë, mbetet e paqartë se pse autorët e Gramatikës së Akademisë në këtë rast janë përcaktuar që emrin në gjinore ta marrin si ndajshtim, ndonëse po të njëjtit autorë, për dallim nga Prifti dhe Buchholz/ Fiedler, nuk e kanë konsideruar fare ta marrin si ndajshtim gjinoren të emrat gjeografikë. Lidhur me këtë, është interesant që Buchholz/ Fiedler (1987: 426) tash pohojnë të kundërtën: nëse gjinorja i shkon pas një përemri, atëherë ai është përcaktor e jo ndajshtim. Sipas atyre gjinorja edhe në këtë rast bënë modifikimin e fjalës bosht, pavarësisht se fjalë bosht është një përemër në vetën e I-rë apo të II-të, e jo një emër. Në këtë punim nuk do të merret anë qoftë për njërën apo për zgjidhjen tjetër, por meqë nuk ekziston një mendim i unifikuar dhe nëse këto dy zgjidhje mund të konsiderohen si dy alternativa opsionale, atëherë padyshim se orientimi në këtë punim do të ishte kah propozimi i Buchholz/ Fiedler, i cili siguron që kriteri i ko-referencialitetit të realizohet edhe në rrafshin sintaksor. Natyrisht, studimet e mëtutjeshme eventuale mund të tregojnë se cila është zgjidhja përfundimtare.

Sidoqoftë, një çështje tjetër, e cila mund të shkakton ndryshime, por kësaj radhe në rrafshin morfologjik, mbetet çështja e tiparit të vetës<sup>37</sup>. Konkretisht, kur ndajshtimi merr përsipër të kryen funksionet sintaksore të përemrit domosdo vjen deri te s'përputhja në tiparin e vetës, sepse emri gjithnjë bartë vetën e III-të<sup>38</sup>, kurse përemri është ose në vetën e I-rë ose në vetën e II-të. Rrjedhimisht, kur ndajshtimi rimerr funksionin sintaksor nga përemri, një rimarrje e tillë detyrimisht reflektohet në mbaresën e foljes:

- (43) a. Ne linguistët hulumtoj-**më**...  
b. Linguistët hulumtoj-**në**...

duke e shndërruar atë nga **-më** te (43a) në **-në** te (43b). Reflektimi i s'përputhjes në vetë është i dukshëm edhe te trajta e shkurtër e përemrit të rimarrja p. sh. e kundrinës së drejtë:

- (44) a. Ankthi **më** kaploi mua mjeranin<sup>39</sup>.  
b. Ankthi **e** kaploi (atë) mjeranin.

nga **më** te (44a) në **e** te (44b).

Në gjuhën gjermane në dukje të parë kriteri i ko-referencialitetit nuk mund të aplikohet sepse mungon nyja shquese:

- (45) a. ihr Linguisten seid ... (veta e II-të shumës)  
b. Linguisten sind ... (veta e III-të shumës)

<sup>37</sup> Në këtë punim, për dallim nga Dhima (2005:70) i cili pohon se veta në gjuhën shqipe është kategori e brendshme e foljes, ne do të konsiderojmë se veta është tipar i brendshëm i emrit dhe tipar kontekstual i foljes. Shiko lidhur me këtë Corbett (2006: 131-132), por edhe Demiraj (1986:677) sipas të cilit: " Kategoritë gramatikore të vetës dhe të numrit edhe në sistemin foljor të shqipes së dokumentuar, ashtu si në gjuhët e tjera i.e., kanë karakter sintaksor, duke u kushtëzuar nga veta e kryefjalës se fjalisë. (Nënvizuar nga T. A.). Lidhur me argumentet shtesë shiko Abrashi (2014) dhe literaturën e cituar aty.

<sup>38</sup> Lidhur me tiparin e vetës te emri dhe te domeni emëror shiko Abrashi (2017) dhe Abrashi (2014)

<sup>39</sup> Prania e kundrinës së drejtë të shprehur me përemër vetor të vetës së parë e të dytë njëjës e shumës në rasën kallëzore shënjohet me anë të trajtës së shkurtër të këtyre përemrave: *Ai më thirri mua për ndihmë*. Shiko Gramatikën e Akademisë (2002:259)

Mirëpo në gjuhën gjermane, nëse emri shënon një klasë të sendeve në shumës, siç është rasti në (45a), atëherë ai mund të shfaqet edhe pa nyja gjegjësisht edhe pa përemër (44b)<sup>40</sup>, prandaj meqë kësisoj ndajshimi mund të kryen funksionet sintaksore, themi se kriteri i ko-referencialitetit është i zbatueshëm. Rrjedhimisht, kur konstruksioni përemër plus emër është në shumës, konstruksioni mund të konsiderohet se është një konstruksion me ndajshim dhe sikurse në gjuhën shqipe edhe në gjuhën gjermane vjen deri te ndërimi i mbaresave foljore, kur përemri zëvendësohet me ndajshimin (emrin).

Mirëpo, kur ky konstruksion është në njëjës, atëherë na paraqitet një situatë më e ndërlikuar, sepse konstruksioni me përemër shfaq kufizime semantike. Konkretisht, në shumës secili emër, i cili ngërthen në veti tiparin [+Human]<sup>41</sup>, mund ti shkoj pas përemrit vetor pa kufizim në interpretimin e tij. Në njëjës, ky interpretim është i kufizuar dhe lidhet (me sa duket vetëm) me një interpretim emocionalisht të ngarkuar të emrit<sup>42</sup>. Kështu p. sh. konstruksionet me përemrin e vetës së I-rë zakonisht lidhen me një interpretim të një vetëkritike (*ich Idiot-unë idioti*) apo një keqardhje ironike (*ich Feigling-unë qyqari*), kurse veta e II-të njëjës ka të bëjë me shprehjet, të cilat mund të janë ofenduese (*du Idiot- ti idioti*), admiruese (*du Engel-ti engjulli*) apo vlerësuese (*du Genie-ti gjeniu*). Kësisoj, në një kontekst të caktuar, sintagmat si *du Linguist :ti gjuhëtar* mund të interpretohen vetëm si një ironi ofenduese drejtuar një personi, i cili p. sh. jep sugjerime për çështje gjuhësore, ndonëse fare nuk është kompetent për sugjerime të tilla<sup>43</sup>. Bhatt (1990: 155) supozon se një kufizim i tillë semantik gjatë përzgjedhjes së plotësit nga ana e përemrit të vetës së I-rë dhe të II-të njëjës ka të bëjë me faktin se këta dy pronorë bartin edhe ashtu tipare shumë më specifikuere në krahasim me pronorët përkatës në shumës. Sipas saj, *ich (unë)* është pa mëdyshje më specifik se *wir (ne)*, prandaj i pari mund të merr vetëm plotësa "kualifikues" (pra që mund të kanë interpretim kritik, vlerësues etj) e jo edhe "specifikues". Kurse në shumës, te përemrat përkatës, ngjashëm sikurse te përemri vetor i vetës së III-të, për shkak se tipari i tyre është më pak specifikues (pothuajse minimal), pas përemrit mund të vijë një plotës si specifikim shtesë. Krahasimet në shembullin vijues (46), të marrë nga Lawrenz (1993: 93), tregojnë se emrat "jo-kualifikues" (gjegjësisht pa një interpretim emocional) mund të merren si plotës nga ana e përemrave vetor të vetës së II-të njëjës vetëm nëpërmjet parafjalës *als (si)*:

- (46) a. Ich \* Älteste/**als** Älteste muss mich um gesamte Haushalt alleine kümmern.  
Unë \* më e vjetra/si më e vjetra duhet vet të kujdesëm për krejt buxhetin e shtëpisë.  
b. Ich \* Hausfrau/**als** Hausfrau muss mich um gesamte Haushalt alleine kümmern.  
Unë \* amvise/**si** amvise duhet vet të kujdesëm për krejt buxhetin e shtëpisë.  
c. Ich \* Mann/**als** Mann muss mich um gesamte Haushalt alleine kümmern.  
Unë \* Burrë/**si** burrë duhet vet të kujdesëm për krejt buxhetin e shtëpisë.

Kurse (45) e tregon të kundërtën: se si emrat "kualifikues" nuk mund të merren nëpërmjet parafjalës *als (si)*:

<sup>40</sup> Helbig/Buscha (1996: 377)

<sup>41</sup> Sepse veta e I-rë dhe veta e II-të i referohen vetëm njerëzve

<sup>42</sup> Në lidhje me këtë çështje shiko Vater (1998:15)

<sup>43</sup> Shiko Vater (1998:15)

- (47) a. Ich Arme/ \*als Arme muss mich um gesamte Haushalt....  
Unë i mjeri/ \*si i mjeri duhet vet të kujdesëm për krejt buxhetin ....
- b. Ich Unglückliche/\*als Unglückliche muss mich um gesamte Haushalt ...  
Unë i pafati/\* si i pafati duhet vet të kujdesëm për krejt buxhetin ....
- c. Ich Bedauerswerte/\* Ich Bedaurswerte muss mich um gesamte Haushalt ...  
Unë i mishëruari/\*si i mishëruari duhet vet të kujdesëm për krejt buxhetin ....
- (48) a. Wie konnte ich /Tor/ \* als Tor nur auf einen solchen Scharlatan hören.  
Si pata mundësi unë budallai/\*si budallai ta dëgjoj një sharlatan të tillë.
- b. Wie konnte ich Idiot/ \*als Idiot nur auf einen solchen Scharlatan hören.  
Si pata mundësi unë idioti/\*si idioti ta dëgjoj një sharlatan të tillë.
- c. Wie konnte ich \*Gelehrter/als Gelehrter nur auf einen solchen Scharlatan hören.  
Si pata mundësi unë \*dijetari/si dijetari ta dëgjoj një sharlatan të tillë.
- d. Wie konnte ich \*Erwachsener/als Erwachsener...  
Si pata mundësi unë \*i rrituri/ si i rrituri ta dëgjoj ....

Sidoqoftë, është evidente se te konstruktionet me përemër si fjalë bosht të gjuhës gjermane, për shkak të mungesës së nyjës, kriteri i ko-referencialitetit në rrafshin sintaksor nuk mund të kënaqet plotësisht. Mirëpo, një mendim i prerë, se a janë në këtë gjuhë këto konstrukcione me apo pa ndajshtim, nuk ekziston. Monografitë (p. sh. Molitor 1979:128) dhe punimet e tjera (p. sh. Vater 1998:17) në këtë fushë zakonisht nuk i konsiderojnë si konstrukcione me ndajshtim, për dallim nga gramatikat si Helbig/Buscha (1996: 609) apo DUDEN (2016:986) të orientuara më tradicionalisht, të cilat i konsiderojnë këto konstrukcione me ndajshtim.

Mjerisht për gjuhën shqipe nuk kam hasur në një hulumtim gjuhësor, që analizon këto konstrukcione për të hulumtuar se cilat emra mund të jenë plotësa të përemrave të vetës së I-rë dhe të II-të dhe a kanë këta emra kufizime semantike të ngjashme si emrat në gjuhën gjermane. Mirëpo, nëse marrim parasysh shembujt e mësipërm (gjegjësisht përkthimet e shembujve të gjuhës gjermane), dhe nëse te të gjithë shembujt ku është përdor parafjala *si* hiqet nyja shquese, atëherë në shembujt e mësipërm (47) dhe (48) të markuar me shenjën (\*) si gramatikisht jo korrekt, shndërrohen në shembuj gramatikisht të pranueshëm:

- (49) a. Unë i mjeri/ si i mjerë duhet vet të kujdesëm për krejt buxhetin ....
- b. Unë i pafati/ si i pafat duhet vet të kujdesëm për krejt buxhetin ....
- c. Unë i mishëruari/si i mishëruar duhet vet të kujdesëm për krejt buxhetin ....
- (50) a. Si pata mundësi unë budallai/si (një) budalla ta dëgjoj një sharlatan të tillë.
- b. Si pata mundësi unë idioti/si (një) idiot ta dëgjoj një sharlatan të tillë.
- c. Si pata mundësi unë dijetari/si (një) dijetar ta dëgjoj një sharlatan të tillë.
- d. Si pata mundësi unë i rrituri/ si i rritur ta dëgjoj një sharlatan të tillë.

Shembujt në (49) dhe (50) japin indikacione se kufizimet eventuale semantike në gjuhën shqipe janë më ndryshe se kufizimet në gjuhën gjermane. Për shkak të hapësirës dhe kuadrin të ravijëzuar në këtë punim, nuk po vazhdojmë më tutje me problematikën e plotësive të përemrave të cekur, por është me rëndësi të konstatojmë se dallimi në kufizimet semantike të plotësive

paraqet edhe një dallim tjetër ndërmjet konstruksioneve ndajshtimore të gjuhës shqipe dhe gjuhës gjermane.

Si përfundim po themi: konstruksionet ndajshtimore me përemër si fjalë bosht në gjuhën shqipe dhe gjuhën gjermane dallohen si në rrafshin sintaksor ashtu edhe në rrafshin semantik. Pra, edhe këto konstruksione ndajshtimore e hedhin poshtë pohimin e Uhlisch. Gjithashtu, për gjuhën shqipe mbeten eventualisht dy çështje si problematike, të cilat kërkojnë një studim të mëtutjeshëm: e para, rastet kur ndajshtimi është në gjinore si p. sh. *ti i shkollës*, te të cilat kriteri ko-referencialitetit realizohet në rrafshin semantik, por jo edhe në atë sintaksor, dhe e dyta, çështja e nyjës së shquar të konstruksionet e vetës së II-të, qoftë në njëjës apo në shumës, për shkak të konstruksioneve thirrrore, siç janë: *O ju pleq, o ju mre shopa...*(shembull i marr nga Prifti (1971:102)) te të cilat nyja e shquar, për dallim nga konstruksionet e tjera ndajshtimore me fjalë bosht përemrin, nuk është e pranishme.

## 8. Struktura dhe lidhjet sintaksore të ndërtimeve ndajshtimore

Çështja e lidhjes (relacionit) ndërmjet fjalës bosht dhe ndajshtimit është një çështje e cila në vazhdimësi ka tërheqë vëmendjen e gjuhëtarëve dhe për të nuk ka një mendim të prerë<sup>44</sup>. Natyrisht, ky punim nuk synon të propozon një përgjigje rreth kësaj çështje, por për qëllim ka të pasqyrojë përputhjet dhe s'përputhjet eventuale të kësaj lidhje, të cilat dalin nga të dhënat (shprehjet) konkrete gjuhësore të gjuhës shqipe dhe gjuhës gjermane. Konkretisht, ne do të provojmë se ç'lidhje sintaksore janë të pranishme në shembujt e mësipërm dhe si reflektohet ajo në strukturën e konstruksioneve ndajshtimore. Po fillojmë me shembujt te të cilët në të dy gjuhët struktura është e njëjtë:

- (51) a. *komisar* Memoja (shqip)                      *Kommissar* Memo (gjermanisht)  
b. [NP<sub>∅</sub>] + [DP<sub>NOM</sub>]                                      [NP<sub>∅</sub>] + [DP<sub>NOM</sub>]

dhe po shikojmë se cila nga tri llojet e lidhjeve brenda sintagmës (përshtatja, drejtimi dhe bashkimi) janë të pranishme në konstruksionet ndajshtimore me strukturë si në (51b).

**Përshtatja:** apo kongruenca nënkupton se gjymtyrët e sintagmës përshtaten duke marrë tiparet gramatikore nga fjala bosht. Konkretisht, supozohet se secila sintagmë emërore ka katër tipare gramatikore: rasën, gjininë, numrin dhe vetën. Në rastin tonë, sa i përket rasës, vërejtëm se te shembujt si në (51), ndajshtimi në të dy gjuhët ka gjithnjë formë të njëjtë, pavarësisht se në ç'rasë është emri bosht, prandaj themi se përshtatja në rasë përjashtohet në të dy gjuhët.

Edhe përshtatja në gjini nuk është e pritshme, sepse të dy gjymtyrët janë emra dhe secili prej tyre ka, si një tipar të pavarur dhe të brendshëm, gjininë e vet, e cila nuk kufizohet nga ndonjë relacion sintaksor. Por, përputhja në gjini ndërmjet fjalës bosht dhe ndajshtimit është e mundshme. Kështu p. sh. te shembulli *lumi Osum*, si fjala bosht (*lumi*) ashtu edhe ndajshtimi (*Osum*), janë të gjinisë mashkullore. Mirëpo, në shembullin tjetër kjo përputhje nuk është e pranishme: *lumi Vjosë*, fjala bosht *lumi* është e gjinisë mashkullore, ndërkaq ndajshtimi *Vjosë* është i gjinisë femërore. Ngjashëm është edhe në gjuhën gjermane: te shembulli *der Fluss Rhein*, (*lumi Rajna*) të dy gjymtyrët, *der Fluss* (*lumi*) dhe *der Rhein* (*Rajna*), janë të gjinisë mashkullore. Kurse në shembullin *der Fluss Donau* (*lumi Danub*), emri bosht *der Fluss* (*lumi*) është emër i gjinisë mashkullore, kurse *die Donau* (*Danubi*) në gjuhën gjermane është i gjinisë

<sup>44</sup> Shiko lidhur me këtë çështje Molitor (1979) dhe Eisenberg (2013:258)

femërore. Por kjo nuk do të thotë se në gjini herë ka e herë s'ka përshtatje gjegjësisht se në gjini ka një përshtatje të pjesshme<sup>45</sup>. Por, mund të thuhet se në gjini në të dy gjuhët ka përputhje dhe s'përputhje të rastit.

Lidhur me tiparin e numrit, Molitor (1979:25), duke u bazuar në gramatikat e mëhershme si dhe shembujve, të cilët ai i paraqet, vjen në përfundim se në gjuhën gjermane te konstruksionet ndajshtimore të paveçuar, ndërmjet gjymtyrës bosht dhe ndajshtimit gjithnjë është e pranishme përshtatja (kongruenca) në numër. Ngjashëm mendon edhe Löbel (1986:80): nëse sintagma e parë e konstruksionit është në shumës, atëherë edhe sintagma e dytë duhet të jetë në shumës. Mirëpo Lawrenz (1993:47) mendon ndryshe, sepse disa konstruksione ndajshtimore si në vijim dëshmojnë të kundërtën<sup>46</sup>:

- |      |                            |                            |
|------|----------------------------|----------------------------|
| (52) | a. Die Brüder Schlegel     | Vëllezërit Schlegel        |
|      | b. *Schlegel sind Brüder.  | *Schlegel janë vëllezër    |
|      | c. Schlegels sind Brüder.  | Schlegel-ët janë Vëllezër. |
| (53) | a. Die Berge Shikoku       | Vargmalet Shikoku          |
|      | b. * Shikoku sind Berge    | Shikoku janë vargmale      |
|      | c. Shikoku ist ein Gebirge | Shikoku është një mal.     |

Vërehet qartë se parafrazimi i (52a) nuk është i mundshëm (52b) pa mbaresën (*s*) në (52c), e cila siguron përshtatjen në numër. Ngjashëm është edhe në shembullin (53). Vërejmë se parafrazimi është i mundshëm vetëm nëse folja këpujore (*ist*) është në njëjës (53c), por jo edhe kur ajo është në shumës (*sind*) si në (53b), që dëshmon se pavarësisht se gjymtyra bosht është në shumës (*die Berge*), ndajshtimi mund të jetë në njëjës (*Shikoku*). Në anën tjetër mund të vërehet se konstruksionet ndajshtimore në vijim janë të papranueshme, ani pse përputhja në numër është e pranueshme:

- |      |  |                   |
|------|--|-------------------|
| (54) | a. * die Bäume Kiefern (vs. die Bäume Kiefer und Eibe) | *pemët halorët    |
|      | b. Kiefern sind Bäume                                  | Halorët janë pemë |

Thënë ndryshe, në gjuhën gjermane nuk ka përshtatje në numër, por ngjashëm sikurse te gjinia, ka përputhje (dhe s'përputhje) të rastit. Prandaj, në gramatikat e botuar së voni, p. sh. Eisenberg (2013) apo Duden (2016) një përshtatje e tillë nuk përmendet.

Te gramatikat e gjuhës shqipe përshtatja në numër e ndajshtimit dhe gjymtyrës bosht konsiderohet si karakteristikë identifikuese e konstruksioneve ndajshtimore. Kështu p.sh. sipas Gramatikës së Akademisë (2002:237): "Ndajshtimi është një lloj përcaktori i shprehur me emër të pashquar që përshtatet në numër me gjymtyrën e përcaktuar", por jo edhe në tipare të tjera, andaj edhe quhet "përcaktori me përshtatje të pjesshme" (fq. 223)<sup>47</sup>. Efekti i këtij pohimi gjegjësisht rregulle vërehet edhe te përdorimi i saj p. sh. te titujt e librave:

<sup>45</sup> Përshtatja është një relacion asimetric, prandaj nëse është e pranishme, atëherë ajo duhet të jetë e pranishme pa përjashtim të të gjitha konstruksionet, të cilat kanë strukturë të njëjtë sintaksore, e jo vetëm te disa prej tyre, qoftë edhe nëse refleksi morfologjik mungon. Shiko Corbett (2006)

<sup>46</sup> Për shembujt e tjerë dh diskutimet rreth kësaj çështje shiko Lawrenz (1993:47)

<sup>47</sup> Edhe Dhima (2005: 91) pohon se ndajshtimi është një përcaktor me përshtatje të pjesshme, por ai nuk tregon se te cili tipar realizohet ajo.

(55) Vëllezërit Karamazovë<sup>48</sup> (e vëllezërit Grimm? Në këtë rast nuk ka ë, prandaj as përshtatje në numër)

Kështu në (55), përkthyesi i romanit e vendosë edhe ndajshtimin (Karamazov) në shumës, duke i shtuar një -ë. Nëse është kështu, atëherë ky është edhe një dallim ndërmjet konstruksioneve ndajshtimore në gjuhën shqipe dhe gjuhën gjermane gjegjësisht kjo është edhe një dëshmi që flet kundër tezës së Uhlisch. Mirëpo, nëse merren parasysh shembujt në vijim të gjuhës shqipe:

(56) a. poema "Këngët e Milosaos", apo  
b. filmi "Zambakët e bardhë"

vërejmë se ndërmjet gjymtyrës bosht (*poema apo filmi*) dhe ndajshtimit (*Këngët e Milosaos* përkatësisht *Zambakët e bardhë*), nuk përputhen në numër, sepse e para është në njëjës, kurse e dyta është në shumës. Por, vërejmë gjithashtu se tipari i numrit të ndajshtimit nuk ka fare ndikim në tiparin e numrit të konstruksionit ndajshtimor:

(57) *Zambakët e Bardhë* është (\*janë) film televiziv i vitit 1983 me regji nga Ilir Bega dhe skenar nga Vangjush Ziko.

sepse në (57) ani pse sintagma emërore (në funksion të kryefjalës) *Zambakët e Bardhë* është në shumës, megjithatë këpuja mund të përdoret vetëm në njëjës (*është*) e jo në shumës (*janë*). Prandaj, kjo na lë të kuptojmë se edhe në gjuhën shqipe mundemi (eventualisht) të themi se nuk ka përshtatje, por mund të ketë përputhje dhe s'përputhje në numër ndërmjet gjymtyrëve. Siç duket një dukuri e tillë jep shenja të universalitetit, sepse ajo është e pranishme edhe në gjuhë të tjera, siç tregon shembulli në gjuhën angleze:

(58) The poem "The three witches" (poema "tri shtrigat")

Shembujt në (56), por edhe fakti se p. sh. në shqipe themi: vëllezërit Grimm (*Gebrüder Grimm*)<sup>49</sup> dhe Jakob Grimm, me ç'rast për shkak të rregullave drejtshkrimore mbiemrit Grimm nuk i shtohet -ë, atëherë mund të jenë dëshmi se teza e Uhlisch është e drejtë, por njëkohësisht ajo e rrëzon atë të Gramatikës së Akademisë. Rrjedhimisht në konstruksionin *Vëllezërit Karamazov*, ngjashëm si te *Vëllezërit Grimm*, ndajshtimi nuk është e domosdoshme të shfaqet në formën e shumësit. Shembulli (57) na dëshmon se këtë nuk e kërkon gjymtyra bosht, sepse edhe ashtu numri i ndajshtimit nuk ndikon në numrin e konstruksionit. Prandaj, në këtë punim, sa i përket përshtatjes në numër ndërmjet gjymtyrës bosht dhe ndajshtimit, mund të konsiderojmë edhe skenarin se ndërmjet gjuhës shqipe dhe gjermane nuk ka dallim gjegjësisht se përshtatja në numër nuk është dëshmi që e kundërshton tezën e Uhlisch. Natyrisht, këtë përfundim po e marrim të kushtëzuar, sepse kujtojmë se ngritja e dilemës në këtë punim se a ka përshtatje në numër ndërmjet gjymtyrëve të konstruksionit ndajshtimor kërkon thellim dhe hulumtim të mëtutjeshëm. Por, ajo që mund të themi është se ndajshtimi jo gjithnjë është i shprehur me emër të pashquar, si në (56) dhe jo gjithnjë përshtatet në numër me gjymtyrën bosht siç pohon

<sup>48</sup> Botuar në Prishtinë më 1984 nga Rilindja dhe përkthyer nga Fadil Bujari. Kështu është edhe te botimi së fundmi nga Uegen, në Tiranë më 2014, përkthyer nga rusishtja nga Jorgji Doksani.

<sup>49</sup> Shiko Buchholz. Fiedler (1987: 25)

Gramatika e Akademisë (2002: 237). Rrjedhimisht përshtatja vetëm në numër nuk mund të merret si një karakteristikë, e cila e dallon ndajshkrimin nga përcaktori.

Në fund, para se të vazhdojmë me relacionin e drejtimit, na mbetet tipari i vetës, i cili për emrat është i fiksuar në leksikon në vetën e III-të. Rrjedhimisht, secili emër ka tiparin e vetës dhe meqë prania e saj tek emrat nuk është rrjedhojë e një relacioni asimetrik sintaksor, por thjesht një veti leksikore, atëherë themi se as te ky tipar, në të dy gjuhët, nuk ka përshtatje.

**Drejtimi:** dalja e ndajshimit në emëroren e pashquar, sidomos te konstruksionet ku ata shënojnë tituj, i ka shtyrë disa gjuhëtarë të supozojnë se në këto raste një relacion i tillë ndajshimor bazohet në relacionin e drejtimit (gjerm. *Rektion*). Kështu p. sh. Eisenberg (1986: 243) thotë se emri bosht (*Memo*) e drejton rasën e ndajshimit-titull (*Kommissar*) dhe numrin e tij (në njëjës). Por, pas kritikës rreth kësaj çështje të bërë nga Lawrenz (1993: 35) se në gjuhën gjermane (sikurse te disa gjuhë të tjera p. sh. shqipe) emri mund të drejtoi emrin vetëm në gjinore dhe atë vetëm nga ana e djathtë<sup>50</sup> si dhe kritika se numri nuk përcaktohet nga gjymtyra bosht, Eisenberg (2013:258) e modifikon pohimin e tij, duke thënë se drejtimi në këtë rast nuk është një drejtim si tipar leksikor i emrit, por është një drejtim si tipar i strukturës dhe si i tillë paraqet një çështje problematike. Prandaj, sikurse Lawrenz (1993:34), ai supozon se emërorja e pashquar është një rasë e paracaktuar (*Defaultkasus*). Thënë ndryshe, te konstruksionet ndajshimore edhe nëse (eventualisht) drejtimi është i pranishëm, atëherë (sipas tij) ky drejtim nuk është një relacioni në kuptimin tradicional. Kurse, sa i përket drejtimit të numrit, Eisenberg në botimin e ri e ka tërhequr dhe nuk e përmend fare një pohim të tillë. Si përfundim lidhur me relacionin e drejtimit mund të themi: asnjëri tipar i ndajshimit nuk drejtohet nga gjymtyra bosht. Sa i përket rasës, për ne është e rëndësishme se edhe në gjuhën shqipe emërorja mund të konsiderohet si një rasë e parapërcaktuar, që do të thotë se në këtë pikëpamje ndërmjet dy gjuhëve ka një përputhje.

**Pranëvënia apo Bashkimi:** relacioni sintaksor ndërmjet gjymtyrës bosht dhe ndajshimit më shumë i ngjet relacionit të pranëvënies apo bashkimit, sepse sipas Gramatikës së Akademisë (2002: 86) "bashkimi është ai lloj i lidhjes nënrenditëse ku fjala e varur është një fjalë e pandryshueshme". Te konstruksionet ndajshimore si në (51) vërejtëm se ekziston një relacion asimetrik ku gjymtyra e nënrenditur (ndajshimi) është një fjalë me formë të pandryshueshme. Një relacion të tillë e supozon edhe Lawrenz (1993: 30) për gjuhën gjermane dhe sipas saj, ky relacion realizohet në një shtresë më të ulët sintaksore. Madje, në krahasim me përcaktorët, ky bashkim bëhet në nivel të fjalës e jo të sintagmës<sup>51</sup>. Këtë ajo e dëshmon duke bërë disa prova, të cilat po i provojmë në konstruksionet e gjuhës shqipe, për të parë se a realizohet ky relacion sikurse në gjuhën gjermane në një shtresë më të ulët se sa përcaktori në gjinore. Këtu po i paraqesim disa nga këto prova.

**Prova 1:** në shembullin e mëposhtëm:

- (59) a. [Shtëpia dhe vetura] e Agimit ishte ...  
b. [Das Haus und das Auto] Agims war

<sup>50</sup> Kurse ndajshimi në gjuhën gjermane (Lawrenz 1993: 35) dhe shqipe (Gramatika e Akademisë 2002:237) mund të vendoset në të dy anët e emrit bosht.

<sup>51</sup> Të rikujtojmë, struktura sintaksore e një konstruksioni mund të konsiderohet se është shtresore. Kështu p. sh. teoria X-bar, supozon se secila sintagmë është e ndërtuar nga tri shtresa, të futura brenda njëra tjetrës. Në shtresën më të ulët është e vendosur fjala bosht (koka), kurse shtresa më e lartë është sintagma, e cila përfshinë edhe shtresën ku është e pozicionuar koka dhe shtresën e ndërmjet shtresës së ulët dhe më të lartë.



përcaktori në gjinore (*e Agimit*) i referohet të dy përbërësve të kryefjalës (*shtëpia dhe vetura*) duke modifikuar kështu të dy entitetet (*shtëpia e Agimit dhe vetura e Agimit*). Kurse, ndajshtimi mund ti bashkëngjitet vetëm njërit nga përbërësve të kryefjalës:

- (60) a. \*[Demarkacioni dhe dialogu] *Kosovë-Serbi* ishin temat kryesore politike në 2017 ...  
b. \*[Die Demarkation und der Dialog] *Kosovo-Serbien* waren die wichtigsten politischen Stoffe im 2017...

e jo të dy përbërësve të kryefjalës, sepse në (60) bëhet fjalë për demarkacionin Kosovë-Mali i Zi e jo Kosovë-Serbi.

**Prova 2:** Ndajshtimi i paveçuar nuk mund të shfaqet pas gjymtyrës së eliduar bosht:

- (61) a. \*Qeveria Mustafa dështoi më herët se Ø Thaçi.  
b. \* Die Regierung Mustafa ist früher gescheitert als die Ø Thaçi.

sikurse është rasti me përcaktorin në gjinore:

- (62) a. Kopshti i profesorit është më i madh se i Ø farmacistit.  
b. Der Garten des Professors ist grösser als Ø des Apothekers.

**Prova 3:** kur janë njëkohësisht të pranishëm ndajshtimi i paveçuar dhe përcaktori në gjinore (sipas Lawrenz) ndajshtimi gjithnjë është më afër gjymtyrës bosht:

- (63) a. Seksioni "Gjeografi" i Shoqatës për Studime Kanadeze  
b. die Sektion "Geografie" der Gesellschaft für Kanada-Studien

Mirëpo, kështu nuk ndodh edhe me emrat relational, të cilët e përzgjedhin një plotës në gjinore:

- (64) a. Absolventi i Akademisë së Arteve Peter Brodien/ \* Absolventi Peter Brodien i Akademisë së Arteve  
b. der Absolvent der Kunstakademie Peter Brodien/ \* der Absolvent Peter Brodien der Kunstakademie

Siç vërejmë në (64), kur përdoret njëkohësisht plotësi i emrit relational dhe ndajshtimi, atëherë në të dy gjuhët menjëherë pas emrit del plotësi e pas këtij vjen ndajshtimi<sup>52</sup>. Arsyeja për një renditje të tillë mund të jetë pikërisht prania e lidhjes sintaksore të drejtimit ndërmjet emrit relational dhe plotësit, e cila nuk është e pranishme edhe te ndajshtimin. Prandaj, si rrjedhojë emri relational i jep përparësi plotësit kundruall ndajshtimit. Por, shembulli (64) njëkohësisht na lë të kuptojmë se ndajshtimi mund ti bashkëngjitet edhe sintagmës. Sidoqoftë, për ne është e rëndësishme se në këtë pikëpamje bashkimi i ndajshtimit bëhet në shtresat e njëjta sintaksore në të dy gjuhët.

<sup>52</sup> Ngjashëm ishte dashur të ishte edhe me emrat prejfoljor. Lidhur me këtë krahaso modelet e sintagmave emërore NM 6a (Subst + NG<sub>Gen</sub> + PG) dhe NM 6b (Subst + PG + NG<sub>GEN</sub>) te Buchholz/Fiedler (1987: 419) si dhe shiko Memushaj (2005:104) dhe pohimin aty: " Emri ne gjinore vihet i pari kur gjymtyra e përcaktuar është emër foljor.

Nga ajo që u shtrua deri më tani na lë të kuptojmë se ndërmjet gjymtyrës bosht dhe ndajshimit nuk ka një lidhje specifike sintaksore. Nëse kihet parasysh se gjymtyra bosht dhe ndajshimi mund të largohen nga konstruksioni dhe madje ata mund të ndërrojnë edhe rolet e tyre pa shkaktuar ndonjë çrregullim gramatikor dhe kuptimor, atëherë shtrohet pyetja a ka ky konstruksion një strukturë asimetrike, e cila zakonisht supozohet se është e pranishme te konstruksionet ndajshimore, sepse zakonisht thuhet x është ndajshim i y<sup>53</sup>. Mirëpo, relacioni semantik i të dy gjymtyrëve shpesh e vështirëson përzgjedhjen e njëres prej gjymtyrëve si më të rëndësishme, pra fjalë bosht, e cila lejon "modifikimin" e saj nga një gjymtyrë " më pak e rëndësishme". Më herët vërejtëm se kjo situatë në gjuhën gjermane shfaqet kur emrit të përgjithshëm (*Kommissar*) i paravendosej nyja e shquar (*der*), duke rezultuar në një strukturë si në (65a):

- (65) a. [[DP<sub>NOM</sub>] + [DP<sub>NOM</sub>]] (për gjuhën gjermane)  
 b. [DP<sub>NOM</sub> + NP<sub>∅</sub>] (për gjuhën shqipe)

e cila përbëhet nga dy sintagma determinante të bashkërenditura, kurse në gjuhën shqipe struktura përbëhet nga një sintagmë determinante dhe një sintagmë emërore. Nëse kihet parasysh se sintagma determinante në pikëpamje hierarkike pozicionohet më lartë se sintagma emërore<sup>54</sup>, e cila zakonisht është plotësisht i sintagmës determinante, atëherë themi se struktura e gjuhës shqipe është e nënrenditur. Në fakt arsyeja thelbësore e një dallimi të tillë strukturor përkon me natyrën e njës së shquar shqipe dhe gjermane. E para është afiks<sup>55</sup>, kurse e dyta klitik. Ky dallim morfo-sintaksor ndërmjet nyjave më së miri vërehet te konstruksionet me sintagma të bashkërenditura:

- (66) a. Poet-i dhe shkrimtar-i ...  
 b. Der Dichter und Schriftsteller<sup>56</sup> ...

Në gjuhën shqipe nyja është e pranishme te të dy sintagmat (66a), kurse te gjuha gjermane vetëm te sintagma e parë (66b). Rrjedhimisht, për të qenë struktura e konstruksioneve ndajshimore në gjuhën shqipe e bashkërenditur, atëherë ishte dashur që nyja të jetë e pranishme në të dy gjymtyrët. Një prani e tillë në gjuhën shqipe te këto konstruksione përjashtohet, ani pse në gjuhën shqipe nyja përdoret edhe me emrat e përveçëm dhe është e domosdoshme kur ky i fundit kryen funksione sintaksore brenda fjalisë. Kurse, në gjuhën gjermane, mu për shkak të mos pranisë së njës së shquar te emri i përveçëm, ky i fundit zhvendoset në pozicionin sintaksor D, duke rezultuar kështu në dy sintagma të bashkërenditura. Thënë ndryshe, te këto konstruksione ndajshimore në gjuhën gjermane nuk ka një dallim morfo-sintaksor ndërmjet gjymtyrës bosht dhe ndajshimit. Se cila gjymtyrë është bosht, varet (siç thotë Jung (1973: 84)) nga konteksti gjegjësisht "ajo që është më e rëndësishme për shprehjen bëhet gjymtyrë bosht, pjesa tjetër është ndajshim".

<sup>53</sup> Shiko Eisenberg (2013:257)

<sup>54</sup> Shiko Koleci/Turano (2011)

<sup>55</sup> Nyja e shquar e gjuhës shqipe nuk është afiks për shkak se ajo është e prapavendosur, por për shkak të tipareve të saja fonologjike dhe gramatikore. Kështu p. sh. nyjat e prapavendosura të gjuhës bullgare dhe maqedonase ani pse të prapavendosura ato nuk janë afikse, por klitik. Shiko më gjërësisht Abrashi (2012a)

<sup>56</sup> Wenn in der Koordination nur ein D auftritt, handelt es sich um koordinierte NPs. (Kur në bashkërenditje shfaqet vetëm një D, atëherë fjala është për sintagma emërore të bashkërenditura. Përkthyer nga T. A.). Shiko Vater (1993:71)

## 9. Analiza e shembujve me formë të njëjtë në të dy gjuhët

Në këtë seksion do të analizojmë konstruksione, të cilat nëpër gramatikat e të dy gjuhëve janë të trajtuara si konstruksionet ndajshtimore<sup>57</sup>. Këto konstruksione janë të njohura si konstruksione me llagap<sup>58</sup> dhe kanë formë si shembujt në vijim:

(67)	a. Karli i Madh	(Shqip)	Karl <b>der</b> Große	(Gjerm.)
	b. Katarina e Madhe		Katharina <b>die</b> Große	

Për ne këto konstruksione janë interesante sepse, së paku në formë, shfaqin ngjashmëri shumë të mëdha. Kështu nyja shquese te konstruksionet në gjuhën gjermane i përshtatet jo si zakonisht emrit që i paraprinë, por në (67) i përshtatet emrit të cilit i shkon pas. Në (67a) ajo merr formën e gjinisë mashkullore (*der*) duke iu përshtatur emrit mashkullor të cilit i shkon pas (*Karl*), kurse në (67b) ajo ka formën e gjinisë femërore (*die*), sepse i përshtatet emrit të gjinisë femërore të cilit i shkon pas (*Katharina*). Pra, kemi një situatë të ngjashme në të dy gjuhët, nëse kihet parasysh se në gjuhën shqipe nyja e përparme e mbiemrit përshtatet rregullisht në mënyrë të paraqitur pikërisht si në shembujt shqip në (67a) dhe (67b). Përveç kësaj, nëse krahasojmë shembujt e gjuhës shqipe dhe gjermane, vërejmë edhe një ngjashmëri ortografike: të dy gjymtyrët ndajshtimore janë të shkruara me germë të madhe. Në gjuhën shqipe kjo bëhet sepse i gjithë konstruksioni konsiderohet si një emër i përveçëm<sup>59</sup>, kurse në gjermanishte kjo bëhet sepse në këtë gjuhë secili emër shënohet me germë të madhe pa përjashtim a është i përveçëm a i përgjithshëm. Kur kihen parasysh gjitha këto ngjashmëri, atëherë pritshmëria se këto konstruksione kanë ngjashmëri në rrafshin morfologjik, sintaksor dhe semantik ishte dashur të ishin realiste. Madje kjo ngjashmëri i ka shtyrë disa gjuhëtarë si p. sh. Himmelmann (1997:188) të mbështesin tezën se nyjat lidhëse (të mbiemrit e gjinore) si në gjuhën shqipe fillimin e zhvillimit të tyre e kanë pikërisht te këto konstruksione, pra kur nyja e shquar është e vendosur ndërmjet emrit dhe përcaktorit pikërisht si në shembujt e gjuhës gjermane.

Sidoqoftë, të krahasojmë fillimisht ndajshtimet në të dy gjuhët. Në gjuhën gjermane mbiemri *Große* është i emëruar, këtë e dëshmon edhe prania e nyjës shquese (*der* në emërore), kurse në gjuhën shqipe ky emërim i ndajshtimit është "i imponuar" me dhënien e statusit të emrit të përveçëm.

(68)	a. Karli i Madh	(Shqip)	Karl <b>der</b> Große	(Gjerm.)	NOM
	b. i Karlit të Madh		Karls <b>des</b> Großes		GEN
	c. Karlit të Madh		Karl <b>dem</b> Großen		DAT
	d. Karlin e Madh		Karl <b>den</b> Großen		AKK
	e. Karlit të Madh				ABL

<sup>57</sup> Shiko p. sh. Buchholz/Fiedler (1987: 423), por edhe Demiraj (1986: 542) dhe Prifti (1971: 103) për gjuhën shqipe, kurse Duden (2016: 980) dhe Eisenberg 2013: 259)

<sup>58</sup> Shiko Abrashi (2012)

<sup>59</sup> Beci (2005:54). Të kihet parasysh se me të madhe shkruhet edhe rumanishte: *Carol cel Mare*, por edhe në latinishte *Carolus Magnus* dhe gjuhë të tjera.

Në (68) vërejmë se në të dy gjuhët lakohen të dy gjymtyrët e konstruksionit ndajshtimor, si fjala bosht ashtu edhe ndajshtimi. Pra te këto konstruksione ndajshtimi nuk ka formë tipike të emërores së pashquar në gjuhën shqipe dhe emërores në gjuhën gjermane. Rrjedhimisht, struktura sintaksore e këtyre konstruksioneve është si vijon:

- (69) a.  $[[NP_{NOM}] + [AP_{NOM}]]$  (Shqip)  
 b.  $[[DP_{NOM}] + [DP_{NOM}]]$  (Gjermanisht)

Në emërore të gjuhës shqipe ajo përbëhet nga një sintagmë emërore dhe nga një sintagmë (tipike) mbiemërore, pavarësisht se ndajshtimi mbanë statusin e emrit të përveçëm. Kurse në emërore të gjermanishtes ajo përbëhet nga dy sintagma determinante. Disa gjuhëtarë, si Hoffmann (2013: 203) këto konstruksione të gjuhës gjermane nuk i pranojnë si konstruksione ndajshtimore, pikërisht se të dy gjymtyrët e këtyre konstruksioneve lakohen. Sidoqoftë, (69) na dëshmon se këto konstruksione dallojnë për nga struktura e tyre sintaksore.

Të shikojmë tani kur emërzimi i mbiemrit në gjuhën shqipe nuk është i imponuar, por ai është i mirëfilltë:

- (70) a. **i** Madh-**i** Karl  
 b. **i** të Madh-**it** Karl  
 c. **të** Madh-**it** Karl  
 d. **të** Madh-**in** Karl  
 e. **të** Madh-**it** Lekë

Në (70) vërejmë se përveç emërzimit të mirëfilltë edhe konstruksioni ndajshtimor është i mirëfilltë, sepse emri i përveçëm Karl në të gjitha rasiat ka formën e emërores së pashquar. Në këta shembuj vetëm mbiemri i emërzuar lakohet. Prandaj, struktura sintaksore e konstruksionit në (70), në emërore është e njëjtë si ajo për gjuhën shqipe në (65):

- (71)  $[DP_{NOM} + NP_{\emptyset}]$

Pra, ajo është e përbërë nga një sintagmë determinative në rasë përkatëse dhe një sintagmë emërore në emëroren e pashquar.

Në rrafshin sintaksor ky pozicion i mbiemrit në gjuhën shqipe, ku ai merr nyjën e shquar dhe emërzohet, quhet pozicion i markuar i mbiemrit, për dallim nga pozicioni i zakonshëm pas emrit, i cili quhet pozicion i pa markuar<sup>60</sup>. Mbiemri i vendosur në këtë pozicion, ngjashëm si në latinishte, merr një shqiptim emfatik. Ky lloj shqiptimi në gjuhën gjermane është i pranishëm te konstruksionet në (68), pra sikurse në gjuhën shqipe, në pozicionin e markuar të mbiemrit, i cili te kjo gjuhë është pozicioni pas emrit<sup>61</sup>. Nëse tani krahasojmë konstruksionet në (67) të gjuhës gjermane dhe të gjuhës shqipe:

- (72) a. Karli i Madh  $[[Karli_{DP}] + [i_{Madh}_{AP}]]$   
 b. Karl der Große  $[[Karl_{DP}] + [[der_D] + [Große_{AP}]_{DP}]]$

<sup>60</sup> Shiko Buchholz/ Fiedler (1987: 328)

<sup>61</sup> Shiko Marschall (1992)

dhe i zërthejmë strukturat si në (72), vërejmë se në të dy gjuhët struktura përmban edhe nga një sintagmë mbiemërore, sepse sintagma determinative e ndajshimit përmban një sintagmë mbiemërore. Dhe sikur nyja e mbiemrit të mos ishte aq e gramatikalizuar, ashtu që ajo do të kishte mundësi të veçohet nga mbiemri, atëherë edhe në gjuhën shqipe nyja e mbiemrit do të ishte kokë e një sintagme determinative si në gjuhën gjermane. Thënë ndryshe, strukturat në (72) dëshmojnë për një ngjashmëri formale evidente. Një zërthim i strukturës si (72) për ne është i rëndësishëm, sepse na mundëson që krahasimi të bëhet më i saktë. Siç vërejmë në të dy gjuhët është e pranishme komponenta mbiemërore, mirëpo në gjuhën shqipe ajo gjendet në pozicion të pa markuar, kurse në gjuhën gjermane në pozicion të markuar. Kjo nënkupton se përveç këtij dallimi në rrafshin sintaksor, ka dallim edhe në rrafshin fonetikë, sepse siç u tha edhe më herët pozicionet emfatike të mbiemrit janë të kundërta: para emrit në gjuhën shqipe dhe pas emrit në gjuhën gjermane. Këtyre dallimeve mund ti shtohet edhe dallimi morfologjik, sepse mbiemri në gjuhën shqipe mund të emërzohet vetëm kur ai del para emrit. Të shohim në vijim se a ka dallime edhe në rrafshin semantik.

Në shumë gjuhë, përcaktorët marrin kuptime të ndryshme kur pozicionohen para ose pas emrit<sup>62</sup>. Në gjuhët romane realizimi i interpretimeve të ndryshme të po të njëjtës njësi leksikore, duke e pozicionuar atë para ose pas emrit, bëhet rregullisht.

(73)	a. le ami vieil	(mik i vjetër nga mosha)	Frëngjisht
	b. il vieil ami	(mik i vjetër, i kamhmotshëm)	
(74)	a. il amico vecchio	(mik i vjetër nga mosha)	Italisht
	b. il vecchio amico	(mik i vjetër, i kamhmotshëm)	

Kështu ndodh edhe në gjuhën frëngjishte (73) dhe gjuhën italishte (74), me ç'rast shembujt në (73a) dhe (74a) kanë interpretim të ndryshëm me shembujt (73b) dhe (74b): te të parët fjala është për një mik, i cili është i moshuar, kurse te të dytët fjala është për një mik, të cilin e njohim kaherë.

Nëse kihet parasysh se në gjuhën gjermane (angleze etj) mbiemri para dhe pas emrit ushtron edhe funksione të ndryshme sintaksore: para emrit ka funksion atributiv, kurse pas emrit ka funksion predikativ (kallëzuesor), atëherë edhe në gjuhën gjermane është i pritshëm një interpretim i ndryshëm i mbiemrit para dhe pas emrit. Sipas Bolinger (1967) në funksion atributiv, mbiemri e modifikon emrin në mënyrë permanente, d. t. th. në këtë funksion ai e modifikon referencën, rrjedhimisht në këtë funksion ai është një modifikues reference (*reference-modifying*). Kurse, në funksion predikativ modifikimi është i përkohshëm gjegjësisht i kufizuar, prandaj ai mund të modifikon një referent tashmë përcaktuar, i cili në rastin tonë quhet Karl, rrjedhimisht mbiemri në këtë funksion është modifikues referenti (*referent-modifying*). Thënë ndryshe, kur mbiemri *große* është para emrit ai përdoret p. sh. për të dalluar *Karlin e madh* nga *Karli i vogël*, kurse kur *Große* është pas emrit ai përdoret jo për të shënuar ndonjë madhësi fizike si në rastin kur ai ndodhet para emrit, por për të shënuar një madhësi të aftësive të *Karl-it*, qoftë si luftëtar ose si një personalitet i zgjuar etj<sup>63</sup>. Në gjuhën shqipe është e kundërta: mbiemri *i madh* pas emrit përdoret për të dalluar sendet për nga madhësia e tyre fizike, kurse kur ai gjendet para emrit ai përdoret për të lartësuar aftësinë e atij sendi apo individi duke i shtuar nëpërmjet rrafshit fonetik edhe një nuancë të admirimit. Shënimi i llagapeve të personaliteteve të

<sup>62</sup> Shiko më hollësisht rreth kësaj çështje Abrashi (në botim) dhe literaturën e cituar aty.

<sup>63</sup> Ngjashëm është edhe në gjuhët sllave. Krahaso p. sh. *veliki Alexander* me *Alexander Veliki* në maqedonishte.

ndryshme si p. sh. *Karli i Madh* apo *Leka i Madh*, pra ashtu siç është paraparë me drejtshkrimin e gjuhë shqipe nënkupton se mbiemri në gjuhën shqipe bënë modifikimin e referencës e jo modifikimin e referentit, të cilin e bënë mbiemri përkatës në gjuhë gjermane. Shqipfolësi vetëm me anë të kontekstit apo për shkak të pranisë së germës së madhe mund të vjen në përfundim se mbiemri në kombinim me emrin i referohet për një aftësi e jo për madhësinë fizike të një individi. Natyrisht, efekti i germës së madhe vjen në konsiderim vetëm në gjuhën e shkruar.

Si përfundim të këtij seksioni të themi: ndonëse fillimisht patëm një ngjashmëri formale shumë premtuese ndërmjet konstruksioneve të gjuhës shqipe dhe gjermane, pas një analize më të thellë mund të konstatojmë se në fakt këto konstruksione kanë dallime evidente në të gjitha rrafshet gjuhësore. Besoj se këto konstruksione dhe analiza kontrastive e tyre mund të përdoren për të dëshmuar se format e njëjta në të dy gjuhët nuk garantojnë edhe ngjashmëri në rrafshet gjuhësore, siç pretendon Uhlisch.

## 10. Përfundim

Në këtë punim krahasuam konstruksionet me ndajshtim të paveçuar në gjuhën shqipe e gjermane për të provuar pohimin e Uhlisch (1982) se konstruksionet ndajshtimore në gjuhën shqipe dhe gjermane kanë formë dhe përmbajtje të njëjtë. Analiza në këtë punim, e kufizuar vetëm te konstruksionet me ndajshtim të paveçuar, tregoi se pohimi i Uhlisch është i drejtë vetëm në ndërtimet kur ndajshtimi del si titull (si p. sh. *komisar Memoja*), por jo edhe në konstruksionet e tjera, ndonëse këto ndajshtime ushtrojnë po të njëjtat funksione në diskurs. Kur ndajshtimi nuk shënon një titull: struktura sintaksore në gjuhën gjermane përbëhet nga dy sintagma determinante në të njëjtën rasë, kurse struktura në gjuhën shqipe përbëhet nga një sintagmë determinante në rasën përkatëse dhe nga një sintagmë në emërore të trajtës së pashquar. Te këto konstruksione dallimi është i dukshëm edhe në rrafshin morfologjik: në gjuhën gjermane lakohen të dy gjymtyrët e konstruksionit, në gjuhën shqipe vetëm fjala bosht. Më tutje gjatë analizës u konstatua se ndajshtimi në gjinore për disa arsye mund të konsiderohet si çështje problematike: (i) ai jo gjithnjë i referohet emrit bosht, (ii) konstruksionet ndajshtimore me emërore të pashquar nuk janë gjithnjë semantikisht ekuivalente me konstruksionet ndajshtimore në gjinore dhe (iii) në rast të heqjes së emrit bosht, ndajshtimi në gjinore nuk mund të merr funksionet sintaksore të këtij të fundit. Një analizë e ngjashme si e ndajshtimit në gjinore është bërë për të provuar pretendimin e Friedman se rrjedhja e shqipes është ose kundrinë e disa parafjalëve ose ndajshtim i një emri tjetër. Duke përdor kriterin e bashkë-identitetit në rrafshin sintaksor dhe semantik, pohimi i Friedman del se nuk është i drejtë. Duke marr parasysh argumentet e mësipërme analiza e konstruksioneve me ndajshtim të paveçuar në rasë të tjera (përveç në emërore të pashquar) nuk u morr në konsiderim. Analiza u zgjerua edhe te konstruksionet ndajshtimore me përemër si fjalë bosht, me ç'rast u pa se këto konstruksione të gjuhës shqipe dhe gjuhës gjermane gjithashtu dallohen si në rrafshin sintaksor ashtu edhe në rrafshin semantik. Në lidhje me këtë është me rëndësi të thuhet se dallimi në kufizimet semantike të plotësive që marrin përemrat paraqet edhe një dallim tjetër ndërmjet konstruksioneve ndajshtimore të gjuhës shqipe dhe gjuhës gjermane. Në këtë punim u analizua edhe lidhja sintaksore ndërmjet gjymtyrës bosht dhe ndajshtimit e cila rezultoi si një lidhje specifike e bashkimit, me ç'rast bashkimi i ndajshtimit bëhet në shtresat e njëjta sintaksore në të dy gjuhët. Gjithashtu, analiza tregoi se përshtatja vetëm në numër nuk mund të merret si një karakteristikë, e cila e dallon ndajshtimin e paveçuar nga përcaktori. Në seksionin e fundit të këtij punimi analizuam disa konstruksione me një ngjashmëri formale shumë premtuese të gjuhës shqipe dhe gjermane, por pas një analize më

të thellë u konstatua se këto konstruksione kanë dallime evidente në të gjitha rrafshet gjuhësore (fonetik, morfologjik, sintaksor dhe semantik). Besoj se këto konstruksione dhe analiza kontrastive e tyre mund të përdoren për të dëshmuar se format e njëjta në të dy gjuhët nuk garantojnë edhe ngjashmëri në rrafshet gjuhësore, siç pretendon Uhlisch.

## 11. Literatura

- Abney, Steven P. (1987): *The English Noun Phrase in its Sentential Aspect*. PhD Thesis. MIT
- Abrashi, Teuta (2009): *Der Kopf der Nominalphrase im Deutschen und Albanischen*, *Ditura* 6, 17-34
- Abrashi, Teuta (2012a): *Nyja e prapavendosur në gjuhët e Ballkanit – ngjashmëri dhe dallimet morfosintaksore / Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit. Albanian and Balkan Languages*. ASHAK, Prishtinë/ fq.235-266
- Abrashi, Teuta (2012b): *Frazat nominale me nyja lidhëse të gjuhës shqipe dhe konstruksionet me llogaritje në gjuhën gjermane*, në: *Studime për nder të Rexhep Ismajlit-me rastin e 65 vjetorit të lindjes*, KOHA, Prishtinë, 1-8.
- Abrashi, Teuta (2013): *A ka fjali njëgjymtyrëshe (pa kryefjalë) nëgjuhën shqipe-refleksion rreth Sintaksës së mehmet Çelikut*, *Studime* 20, 59-84
- Abrashi, Teuta (2014): *Lidhja kryefjalë-kallëzues: përshtatje, drejtim apo të dyja*, *Studime* 21, 325-340
- Abrashi, Teuta (2016): *Das Nähe-Distanz Modell und die Informationsstruktur im Deutschen*, Në: Jülich, Petrović Marina & Vujčić Nikola: *Nähe und Distanz in Sprache, Literatur und Kultur-Beiträge zur 8. Jahrestagung des Südosteuropäischen Germanistenverbandes* (Kragujevac, 11. – 15. November 2015), 37-54
- Abrashi, Teuta (2017): *Zur syntaktischen Eigenheiten des Merkmals Person im Deutschen*, *Germanica Wratislaviensia Nr. 142*, 105-118
- Abrashi, Teuta (në botim): *Die Beinamenkonstruktionen im Deutschen und der Gelenkartikel im Albanischen*, në Ströbel, Andrea (Hrsg.), Regensburg
- Abrashi, Teuta (në proces të botimit): *Zur syntaktischen Verhältnissen bei der deutschen und albanischen engen Apposition*, Prishtinë.
- Acuna-Farina, J. Carlos (1994): *Meyer, Chales F.: Apposition in Contemporary English*, Review, *Atlantis XVI 1-2*, 321-326
- Acuña-Fariña, J. Carlos (2006): *A constructional network in appositive space*. *Cognitive*
- Agel, Vilmos (2017): *Grammatische Textanalyse-Textglieder, Satzglieder, Wortglieder*, De Gruyter, Berlin
- Beci, Bahri (2005): *Gramatika e gjuhës shqipe*, Logos-A, Prishtinë
- Bhatt, Christa (1990): *Die syntaktische Struktur der Nominalphrase im Deutschen*, Gunter Narr Verlag, Tübingen
- Bokshi, Besim (2004): *Për vetorë e shqipes*, ASHAK, Prishtinë
- Bolinger, Dwight (1967): *Adjectives in English: Attribution and Predication*. *Lingua* 8. S. 1-34.
- Buchholz, Oda & Wilfried Fiedler (1987): *Albanische Grammatik*, Enzyklopädie Verlag, Leipzig
- Burton-Roberts, Noel. 1975. *Nominal apposition*. *Foundations of Language* 13, 391–419.
- Çeliku, Mehmet (2012): *Sintaksë e gjuhës shqipe (Përbërësit sintaksorë)-Vështrim i ri teorik*, ILAR, Tiranë

- Cipo, Kristaq (1952): *Sintaksa*, Instituti i Shkencave, Tiranë
- Corbett, Greville (2006): *Agreement*, Cambridge University Press, New York
- Demiraj, Shaban (1986): *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Universiteti i Tiranës, Tiranë
- Dhima, Thoma (2005): *Gjuha shqipe-sintaksa*, Shtëpia botuese e librit universitar, Tiranë
- Domi, Mahir (1971): *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Rilindja, Prishtinë
- DU DEN (2016<sup>9</sup>): *Die Grammatik*, Duden, Berlin
- Eisenberg, Peter (1986): *Grundriss der Deutschen Grammatik*, Metzler, Stuttgart
- Eisenberg, Peter (2013): *Grundriss der deutschen Grammatik*, Bd. 2. *Der Satz*. Metzler Stuttgart.
- Friedman, Victor (2006): The Balkans as linguistic area. *Elsevier Encyclopedia of Language and Linguistics*. Vol. Ed. By Keith Brown. 657-672. Oxford: Elsevier
- Gallmann, Peter (1997): «Zur Morphosyntax der Eigennamen im Deutschen, Nö: Löbel, Elisabeth / Rauh, Gisa (Hrsg.) (1997): *Lexikalische Kategorien und Merkmale*. Tübingen: Niemeyer (= Linguistische Arbeiten, 366), 72–84.
- Gato, Maristella (2014): *The Web as Corpus-Theory and Practice*, Bloomsbury, London
- Gramatika e Akademisë (2002): *Gramatika e Gjuhës Shqipe 2*
- Helbig, Gerhard/Joachim Buscha (1996): *Deutsche Grammatik-Ein Handbuch für Ausländerunterricht*-Langenscheidt-Verlag Enzyklopädie, Berlin
- Henschel, Elke & Harald Weidt (1994<sup>2</sup>): *Handbuch der deutschen Grammatik*, Walter de Gruyter, Berlin
- Hoffmann, Ludger (2013): *Deutsche Grammatik-Grundlagen für Lehrerbildung, Schule, Deutsch als Zweitsprache und Deutsch als Fremdsprache*, Erich Schmidt Verlag, Berlin
- Jung, Walter (1973): *Grammatik der deutschen Sprache*. Leipzig. 5. Aufl .
- Koleci, Flora & Giuseppina Turano (2011): *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*, Universiteti i Tiranës, Dajti 2000, Tiranë
- Krifka, Manfred (2006): Notions of Information Structure, in: *Interdisciplinary Studies on Information Structure 06*, Potsdam, Berlin
- Lawrenz, Birgit (1993): *Apposition-Begriffsbestimmung und syntaktischer Status*, Gunter Narr Verlag, Tübingen  
*Linguistics* 17(1), 1–37.
- Longobardi, Giuseppe (1994): Reference and proper names: a theory of N-movement in syntax and logical form' *Linguistic Inquiry*, pp. 609-665
- Marschall, Gottfried R. (1992): Überlegungen zum nachgestellten Adjektiv im Deutschen. In: Valentin, Paul (Hg.): *Rechts von N. Untersuchungen zur Nominalgruppe im Deutschen*. Narr Tübingen 1992, S. 71–82
- Memushaj, Rami (2005): *Gjuha standarde-si ta flasim dhe ta shkruajmë*, Toena, Tiranë,
- Meyer, Charles F. 1992. *Apposition in contemporary English*. Cambridge: Cambridge
- Molitor, Friedhelm (1979): *Zur Apposition im heutigen Deutsch-Eine Vorstudie*, Dissertation, Universität Köln
- Plank, Frans (2002): Grouping in Multiple Attribution: Advantage Albanian, Nö: Bublitz, Wolfram: *Philologie, Typologie und Sprachstruktur: Festschrift für Winfried Boeder zum 65. Geburtstag*, Peter Lang, Frankfurt, 157-170
- Postal, Paul. 1969. On So-Called "Pronouns" in English. In Reibel, David and Schane, Sanford (Eds.) *Modern Studies in English*. Prentice-Hall Inc.
- Prifti, Stefan (1971): *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Rilindja, Prishtinë



- Prifti, Stefan (1977): Përcaktori në gjuhën shqipe, *Studime Filologjike 1*, 33-59
- Schäfer, Roland (2016<sup>2</sup>): *Einführung in die grammatische Beschreibung des Deutschen: Zweite, überarbeitete Auflage* (Textbooks in Language Sciences 2), Language Science Press, Berlin.
- Schindler, Wolfgang (1990): Untersuchungen zur Grammatik appositionsverdächtiger Einheiten im Deutschen. Tübingen: Niemeyer (Linguistische Arbeiten 246).
- Uhlisch, Gerda (1979): Untersuchungen zum adnominalen Attribut in der albanischen Sprache der Gegenwart, Dissertation, Universität Leipzig
- Uhlisch, Gerda (1982): Zu einigen Aspekten eines albanisch-deutschen Vergleichs der adnominalen Attribute, *Language Typology and Universals*, 456-465  
University Press
- Vater, Heinz (1993): Determinantien in koordinierten NPs. In: Vuillaume/Marillier/Behr (Hrsg.): *Studien zur Syntax und Semantik der Nominalgruppe*, Narr, Tübingen, 65-83.
- Vater, Heinz (1998): Determinantien und Pronomina in der DP, *Acta Germanica 6*, 11-44